



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.13751/9016 (31146-02030-86-2018)Regj.Themeltar
Datë 28.05.2018 regjistrimi

Nr. 1893 (86-2019-2182) Vendimi
Datë 19.06.2019

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

GJYQTAR : Kastriot SELITA

GJYQTARE : Bernina KONDI

GJYQTARE : Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

Asistuar nga sekretare gjyqësore Almeida Cllini në Tiranë në datë 19.06.2019 mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen administrative me nr. 13751/9016 (31146-02030-86-2018) rregjistri themeltar, me palë ndërgjyqëse:

PADITËS: [REDACTED] banues në Njësinë Administrative [REDACTED] Bashkia
Pogradec.
Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

E PADITUR: **Ministria e Shëndetësisë.**
Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

PERSON I TRETË: **Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.**

Me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Tiranë.

OBJEKTI:

- Konstatimin e diskriminimit në formën e "Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme" ndaj fëmijës së mitur [REDACTED]
- Detyrimin e palëve të paditura për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese përmes ndreqjes së shkeljeve ligjore dhe pasojave përmes:
 - i. kryerjes së veprimeve administrative për sigurimin dhe vendosjen e implantit koklear për fëmijën e mitur me probleme të dëgjimit [REDACTED]
 - ii. kompensimit të dëmit jopasuror në formën e dëmtimit të shëndetit (dëmit biologjik) në masën 6.838.590 lekë të shkaktuar nga pala e paditur.
- Shpenzimet procedurale të padisë dhe të gjykimit të saj të paguhen nga pala e paditur.

BAZA LIGJORE: Neni 18, pikat 1 dhe 2, neni 54 pika 1, neni 55 dhe neni 59 pika 1 germa “c”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Nenet 13 dhe

14, si dhe neni 1, i Protokollit nr. 12, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 23 pika 1, neni 24 pikat 1 dhe 2 germa "b", të Konventes së OKB-së "Mbi të drejtat e fëmijës" (ratifikuar me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991). Neni 1 paragrafi 2, neni 2, neni 5 pikat 1 dhe 2, neni 7 pika 1, të Konventës së OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara" (ratifikuar me ligjin nr. 108/2012, datë 15.11.2012). Neni 3 pikat 6, 9 dhe 10, neni 5 pikat 1 dhe 2, neni 10 pika 1 dhe neni 11 pika 1, të ligjit nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara". Neni 1, neni 3, pikat 7 dhe 9, neni 20 pika 1 germa "a", pika 2 germa "b" dhe pika 3, neni 34 pikat 1 dhe 3, neni 36, neni 37 pika 1, neni 38, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2019 "Për mbrojtjen nga diskriminimi". Ligji nr. 3766, datë 17.12.1963 "Për shërbimin shëndetësor dhe dhënien falas të ndihmës mjekësore të shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 7718, datë 03.06.1993 dhe me ligjin nr. 7738, datë 21.07.1993. Neni 30 pika 3, e ligjit 10347, datë 04.11.2010 "Per mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve". Neni 31, neni 32 germa "a", nenet 192-194, të Kodit të Procedurës Civile. Neni 608/1, neni 609/1, neni 625 germa "a" dhe neni 641, i Kodit Civil. Neni 3 pika 7 germa "a" dhe pikat 9 dhe 12, neni 17 pika 3, neni 33 pika 1 germa "a" dhe pika 2, neni 128 pika 1 dhe pika 3 germa "a"/i, nenet 129, 138 dhe 140, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative". Neni 2 pika 5, neni 7 germat "a", "b", nenet 10 dhe 11, neni 15 germat "a" dhe "d"/ii, neni 16 pika 1, neni 17 pika 1 germa ç, neni 18 pika 1 germa "dh", neni 40 pika 1 germa "ç", të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar. VKM nr. 308, datë 21.05.2014 "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor". Vendimi unifikues nr. 12, datë 14.09.2007, i Gjykatës së Lartë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018, ka vendosur:

- Pranimin e pjesëshëm të padisë.
- Konstatimin e diskriminimit në formën e "Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme" ndaj fëmijës së mitur [REDAKTUAR]
- Detyrimin e palëve të paditura që solidarisht të marrin masat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese përmes riparimit të shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura:
 - a) kryerjes së veprimeve administrative për sigurimin dhe vendosjen e implantit koklear për të fëmijën e mitur me probleme të dëgjimit [REDAKTUAR]
 - b) kompensimin e dëmit në formën e dëmtimit të shëndetit në masën 6.838.590 lekë.
- Rrëzimin e padisë për sa i përket paditësit Komiteti Shqiptar të Helsinkit për mungesë të legjitimitetit aktiv.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palëve të paditura.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe në çastin kur merr formë të prerë ekzekutohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Zyrat e Përmbarimit në Republikën e Shqipërisë.
- Ekzekutimi i këtij vendimi në lidhje me masën e kompesimit financiar të bëhet pranë zërit buxhetor të FSDKSH brenda 1 viti nga marrja e këtij vendimi formë të prerë.

- Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve nga e nesërmbja e komunikimit të vendimit të arsyetuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Ministria e Shëndetësisë, në të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018 dhe rrëzimin e kërkesë padisë, për këto arsye:

- Ky vendim është i pabazuara në ligj dhe në prova, dhe ky vendim duhet ndryshuar duke vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në prova dhe ligj.
- Gjykata pas verifikimit të juridiksonit dhe kompetencës, proceduralisht dhe në këndvështimin e të drejtës materiale, duhet të verifikojë dhe një nga kushtet thelbësore për dhënien e vendimit, që është ekzistenca e legjitimitimit aktiv dhe pasiv të palëve në proces (legitimatia ad causam). Konkretisht paditësi mendon se ka legjitimitimin aktiv, pasi në marrëdhënien juridiko-materiale pretendon se është diskriminuar në formën e “Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme” ndaj fëmijës Gisel Leka, ndërsa ajo që duhet të vërtetohet dhe që i përket hetimit gjyqësor dhe themelit të çështjes, është legjitimitimi pasiv i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Sociale.
- Referuar VKM-së nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”. i ndryshuar, në shtojcën 5 parashikohet se: *“Aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së, sigurohet në çdo rast nga MSH-ja”*. Pala paditëse ashtu sikurse dhe gjykata bazuar në këtë VKM kanë legjitimuar ministrinë si palë e paditur në këtë proces, kur në fakt gjatë gjykimit si dhe bazuar në VKM rezultoi dhe u provua se roli i ministrisë për të siguruar aparatën koklear nuk parashikon momentin spcifikik kur ministria duhet ta siguroj aparatën si dhe nuk parashikon as dhe mënyrën e sigurimit të aparatit.
- Referuar VKM-së nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, paketa e shërbimit të implantit koklear financohet plotësisht si shërbim i rimbursueshëm nga Fondi. Në listën e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shtojcën nr. 5 “Paketa e shërbimit të implantit koklear”: *“Aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së, sigurohet në çdo rast nga MSH-ja”*.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me urdhrin nr. 258, datë 16.06.2014 “Për miratimin e protokolleve e të paketave të shërbimeve që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ka miratuar protokollin përkatës, konkretisht edhe protokollin e implantit koklear. Në pikën 2 të këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor për përzgjedhjen e ofertuesve të shërbimeve, me të cilët do të kontraktohet si dhe ndjekjen e zbatimit të protokolleve të sipërcituara.
- FSDKSH ka hartuar me vendimin nr. 88, datë 09.07.2014 “Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrisë Kombëtare të Paketave të Financuara nga Fondi”, të ndryshuar, të Kryetarit të Këshillit Administrativ, në të cilin përcaktohen rregullat kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrisë Kombëtare të Paketave të financuara nga Fondi, si dhe udhëzimin nr. 26, datë 07.11.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH “Për adiministrimin e Regjistrisë Kombëtare të Paketave”. Regjistri Kombëtar i Paketave të financuara nga FSDKSH është dokumenti shtetëror i mbajtur në formë elektronike dhe fizike, ku pasqyrohen përfituesit e paketave të shërbimeve shëndetësore që financohen nga Fondi. Regjistri ka formën e një libri të hapur për çdo paketë shërbimesh shëndetësore, ai mbahet në zyrat e autorizuara të Fondit dhe

administrohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Në pikën 5 të këtij vendimi, përcaktohen dokumentat bazë mbi të cilat kryhen veprimet në Regjistrin Kombëtar të Paketave në lidhje me pacintët janë: a) Vendimi i konsultës së shërbimit përkatës; b) Formulari i prioritetit të trajtimit; c) Karta e identitetit; d) Karta e shëndetit; e) Vendimi i konsultës së shërbimit të urgjencës.

- Dokumenti bazë që jepet nga dhënësit e shërbimit shëndetësor të kontraktuar me Fondin dhe mbi të cilin kryen veprime në Regjistrin Kombëtar të Paketave është formulari i informacionit të përditësuar mbi kapacitetet e lira për çdo paketë shërbimi. Dokumenti bazë që lëshohet nga zyra e autorizuar e Fondit për përfituesit e shërbimeve të paketave është dokumenti autorizues për kryerjen e shërbimit. (elektronikisht dhe manualisht). Emri i të mituri [REDAKTUAR] nuk pasqyrohet në këtë regjistrë. Pra nuk mund të jetë subjekt i përfitimit të paketave të shërbimit shëndetësor që do të financohen nga FSDKSH.
- Gjykata bazuar në shkresën nr. 1513/1, datë 22.04.2016 “Kthim përgjigje” dhe shkresës nr. 1329/1 prot, datë 23.03.2016 “Përgjigje shkrese”, të FSDKSH, ka konkluduar se aparati koklear nuk është siguruar nga ministria dhe për këtë arsye ka vendosur se ministria nuk ka realizuar detyrimin ligjor për sigurimin e implantit koklear. Pra për aq kohë sa në Regjistrin Kombëtar të Paketave të financuara nga FSDKSH, nuk rezulton i regjistruar fëmija [REDAKTUAR] atëherë jemi në rastin kur ministria nuk mund ta sigurojë këtë aparat për shkak të mosregjistrimit të fëmijës, fakt ky i provuar dhe gjatë gjykimit. Për sa më sipër nuk jemi para diskriminimit në formën e “Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme” ndaj fëmijës [REDAKTUAR].
- Përsa i përket detyrimit të të paditurit, të dëmshpërblejë paditësin për dëmin jashtëkontraktor, me pretendimin se dëmi ka ardhur si rezultat i veprimeve/mosveprimeve të paligjshme të të paditurit edhe ky kërkim i paditësit nuk gjen mbështetje në ligj dhe në prova për arsye se:
- Në analizë të dispozitave ligjore nenit 608 e 609, të Kodit Civil, që të lindin detyrime nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor duhet të konkurojnë disa kushte së bashku, këto janë: a) ekzistenca e dëmit; b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit; c) ekzistenca e fajit; d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar është edhe lidhja shkakësore që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Lidhja shkakësore paraqet raportin e ndërsjelltë, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm d.m.th, pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron autorin e saj, në rastin konkret organin administrativ, të shpërblejë dëmin plotësisht (qëndrim ky i unifikuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi unifikues nr.12, datë 14.09.2007). Pra nuk jemi në rastin e kryerjes ose moskryerjes së ndonjë veprimi administrativ nga ministria.
- Gjykata argumenton se ministria nuk vërtetohet se ka zhvilluar procedurat e nevojshme ligjore dhe ka siguruar pajisjen e implantit koklear. Referuar VKM-së nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor“, i ndryshuar, në shtojcën 5, parashikohet se: “Aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së, sigurohet në çdo rast nga MSH-ja (Ministria përgjegjëse për shëndetësinë)” dhe urdhrit nr. 258, 16.06.2014 “Për miratimin e protokollove e të paketave të shërbimeve që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ka miratuar protokollin përkatës, konkretisht edhe Protokollin e Implantit Koklear. Në pikën 2 të këtij urdhri, ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor për

përzgjedhjen e ofertuesve të shërbimeve, me të cilët do të kontraktohet si dhe ndjekjen e zbatimit të protokolleve të sipërcituara, nuk përcaktojnë shprehimisht momentin kur ministria duhet të sigurojë aparatën koklear, por thuhet se në "çdo rast". Në momentin që nuk kemi të planifikuara ndërhyrje kirurgjikale për vendosjen e implantit koklear, atëherë ministria nuk mund të sigurojë këtë aparat. Vetëm në momentin që personi përkatës ndjek procedurat ligjore të referimit dhe përcaktohet institucioni ku do të kryhet ndërhyrja kirurgjikale, atëherë ministria duhet të sigurojë aparatën. Në momentin që nuk kemi asnjë person të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Paketave të financuara nga FSDKSH, për t'u planifikuar për ndërhyrjet kirurgjikale për vendosjen e implanti koklear, pra vendimi i gjykatës se ministria nuk ka siguruar nuk mund të sigurojë këtë aparat, për aq kohë sa në Regjistrin Kombëtar të Paketave të financuara nga FSDKSH, nuk rezulton i regjistruar fëmija [REDAKTUAR], atëherë jemi në rastin kur ministria nuk mund ta sigurojë këtë aparat për shkak të mosregjistrimit të fëmijës, dhe moskryeres së ndërhyrjes kirurgjikale, fakt ky i provuar dhe gjatë gjyqimit.

- Kërkesat e paraqitura nga pala paditëse çënojnë parimin e sigurisë juridike, i cili përbën bazën e shtetit ligjor. Në asnjë rast nuk mund të kërkohet përmbushja e detyrimeve të administratës shtetërore pa zbatuar dhe respektuar ligjet mbi të cilin funksionon ajo. Pala paditëse nuk ka zbatuar kërkesat e legjislacionit lidhur me procedurat për përfitimin e kujdesit shëndetësor. Deklarimi fajtor i organit të administratës dhe caktimi i dëmshpërblimit lidhur me të çënon një interes më të madh publik që sanksionohet me tërësinë e ligjeve dhe Kushtetutës në Republikën e Shqipërisë. Çdo disponim tjetër është antiligjor dhe i papranueshëm sepse çënon parimet bazë të skemës së sigurimeve shëndetësore, të transparencës së kontributeve dhe përfitimeve.
- Mbi akt-vlerësimin dëmi të datës 14.12.2017 dhe akt shtesë vlerësim dëmi të datës 11.01.2018: Ky akt-vlerësimi nuk është i bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes në gjykim. Sjellim në vëmendjen e gjykatës se, paditësi nuk ka pësuar ndonjë aksident, por paafësia e tij është e lindur. Sikurse shprehet edhe vetë z. [REDAKTUAR] në përmbajtjen e përgjigjes së pyetjes së tretë ku citon se, "Patologjia që ka i mituri [REDAKTUAR] është një patologji e lindur". Aket e hartuara nga z. [REDAKTUAR] nuk kanë të mirëpërcaktuar bazën ligjore. Kjo dëshmohej jo vetëm prej përgjigjes së ekspertit, por edhe përmes përmbajtjes së vetë akteve.
- Në akt-shtesë vlerësim dëmi të datës 11.01.2018, në përmbajtjen e përgjigjes së pyetjes së tretë citohet se: "*Patologjia që ka i mituri [REDAKTUAR] është një patologji e lindur*". Dëmi që i është shkaktuar fëmijës ka ardhur si pasojë e mosvendosjes së implantit koklear". Si mundet të shkaktohet dëm shëndetësor kur kemi të bëjmë me një patologji të lindur? Në përmbajtjen e përgjigjes së pyetjes së parë citohet se: "*Profesioni im është pediatër i përgjithshëm, por mbështetur dhe në provat mjekësore që ndodhen në dosje si, Kartela Klinike në spital, Raporti Mjekësor nga Shërbimi i Kirurgjisë Infantile, Raporti Mjekësor i Departamentit ORL të Spitalit Hygeia, si dhe nga ekzaminimi objektiv që i kam bërë të miturit, kam dalë në konkluzionin se fëmija është kandidat për implantin koklear*". Ndërsa në përmbajtjen e përgjigjes së dytë citohet se: "*Dokumentat mjekësore mbi të cilat kam vepruar janë ato që citova më lart. I mituri G. L, gjatë qëndrimit në spital i janë bërë të gjitha vlerësimet e dëgjimit, aftësive komunikuese dhe linguistike dhe mbi bazën e këtyre vlerësimeve mjekët specialistë kanë dalë në konkluzionin se e vetmja zgjidhje për rehabilitimin e dëgjimit dhe linguistike është vendosja e implantit koklear*". Si mundet një pediatër i përgjithshëm të përcaktojë nëse një pacient është kandidat apo jo? Kur sipas akteve ligjore dhe nënligjore të depozituara në dosjen gjyqësore, pika 8 e udhëzimit nr. 26,

datë 07.11.2014 përcaktohet se: *“Pacienti, pasi ka zbatuar sistemin e referimit kalon në konsultën e shërbimit përkatës. Konsulta mjekësore e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) mjekë/ shefi i shërbimit dhe të paktën një mjek tjetër specialist, merr vendimin që pacienti të përfitojë paketën duke plotësuar dokumentat përkatës (Vendimi i konsultës dhe formularin e prioritetit të trajtimit)”*. Si mundet që eksperti për të arritur në këto konkluzione, nuk ka marrë në konsideratë shkresën nr. 843/10 prot, datë 18.07.2017, të Shefit të Shërbimit të ORL-së të depozituar në dosjen gjyqësore ku citohet se: *“2. Pacienti është shtruar në svital jo për të kryer ekzaminimet e duhura për implant koklear, por për përfitimin e ndihmës ekonomike...”* dhe *“3. Nuk ka vendim konsulte për të përcaktuar nëse pacienti [redacted] është kandidat për vendosjen e implantit koklear...”* si dhe *“4. Kartela nuk përmban dokumentacionin e nevojshëm për të cilësuar pacientin si kandidat për vendosjen e implantit koklear, pasi arsyeja e shtrimit nuk ka qenë vendosja e implantit koklear”*. Si mundet eksperti të marrë këto tagra ligjor, të cilat nuk i njihen atij nga ndonjë akt ligjor apo nënligjor? Në përmbajtjen e përgjigjes së pyetjes së katërt citohet se: *“Në rastin konkret humbja e aftësisë tek i mituri G. L, është në masën mbi 67%”*. Ndërkohë në akt-vlerësimin e dëmit të datës 14.12.2017, citohet se: *“Shurdhim i plotë i njërit vesh ose i të dyve 15-50%”*, si dhe *“Shkalla e humbjes së aftësisë së pjesshme të përhershme për punë në masën 35%”*. Në këto rrethana, cila duhet konsideruar e saktë? Këto fakte i bëjnë totalisht të pabesueshme akt vlerësimet e z. [redacted]

- Gjykata ka vlerësuar në përputhje me sa parashtrohet pala paditëse, konkretisht se: *“Referuar dokumentit përmbledhje e daljes datë 28.10.2015, të Shërbimit ORL të QSUT-së, për shkak të invaliditetit dhe paafësisë, është rekomanduar që i mituri G. L, të trajtohet me KEMP si dhe është cilësuar si kandidat për CI ose për implant koklear”*. Ky vlerësim i gjykatës nuk përbën argumentim ligjor dhe është në kundërshtim me parimet ligjore materiale dhe procedurale, pasi përmbledhja e datës 28.10.2015 është dokument i hartuar vetëm nga 1 (një) mjek, i cili nuk ka tagrin ligjor të përcaktojë nëse pacienti i përmbush apo jo kriteret mjekësore për përfitimin e paketës së implantit koklear dhe as për ta referuar atë në Zyrën e Regjistrimit Kombëtar të Paketave dhe për të përfituar nga kjo paketë. Për këtë arsye, ky dokument nuk ka vlerë ligjore dhe provuese për të ngarkuar ministrinë me përgjegjësi konkrete në këtë proces.
- Në kërkesë padi, pala paditëse citon si bazë ligjore dispozitat ligjore si vijojnë: Nenin 3, pika 6, të ligjit nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*, ku citohet se: *“Mohim i përshtatjes së arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme, që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”*. Sikurse dëshmohet, nga ana e ministrisë nuk ka *“Mohim të përshtatjes së arsyeshme”*, pasi ministria nuk ka mohuar ose kundërshtuar kryerjen e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Në mbështetje të kuadrit ligjor të ushtrimit të veprimtarisë ligjore dhe në përputhje me ato çfarë i ka ngarkuar ky kuadër, Fondi ka siguruar kushtet dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e nevojave për financim të shërbimeve dhe përkujdesje, me qëllim minimizimin apo heqjen e pengesave për përfshirje, si dhe për rritjen në maksimum të autonomisë dhe jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara dhe jemi në rastin kur ministria

nuk mund ta sigurojë këtë aparat, për shkak të mosregjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Paketave të Financuara nga FSDKSH, fakt ky i provuar dhe gjatë gjykimit.

- Nenin 20, pika 11 shkronja “a”, pika 2 shkronja “b”, dhe pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku citohet se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: b) mundësi për të marrë ose për të përfutur nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; Ndalohet për një person fizik ose juridik, që ofron të mira dhe shërbime për publikun, të mos pranojë ose të kundërshtojë realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara, për sa kohë që këto modifikime apo përshtatje nuk imponojnë një barrë të shpërpjesëtuar ose të paligjshme mbi personin që ofron të mirat dhe shërbimet”*. Në asnjë rast, ministria nuk ka refuzuar t’i japë paditësit të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, të mos ketë pranuar apo kundërshtuar realizimin e ndryshimeve ose përshtatjeve të nevojshme dhe të duhura, të cilat synojnë të mundësojnë përfitimin e këtyre të mirave dhe shërbimeve nga një person me aftësi të kufizuara. Përkundrazi, sikurse u pohua gojarisht nga përfaqësuesi ligjor i palës paditëse në seancën gjyqësore të datës 27.3.2018, u konfirmua fakti se prej paditësit apo kujdestarëve ligjor të tij nuk ka pasur ndonjë kërkesë/ aplikim për të marrë ose për të përfutur nga të mirat apo shërbimet që ofron Fondi apo strukturat e tij vartëse, si dhe nuk i janë drejtuar atyre konform kuadrit ligjor të ushtrimit të veprimtarisë së tij ligjore, pra ministria nuk mundë të sigurojë implantin loklear në rastin konkret për shkak se nuk kemi të regjistruar asnjë person në Regjistrin Komëtar të Paketave.
- Për sa më sipër nuk jemi para diskriminimit në formën e “Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme” ndaj fëmijës [REDAKTUAR]. Nga gjithë sa thamë më lart, arrihet në konkluzionin se pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë dhe faktet ku ai përpigjet të mbështesë pretendimet e tij janë të gjitha të pavërteta. Në arsyetimin e vendimit konstatohet se, gjykata ka kryer hetim gjyqësor duke iu referuar vetëm pretendimeve dhe dokumentacionit të paraqitur nga pala paditëse, si dhe i ka çmuar ato të mirëqena. Në këtë vendim, gjykata nuk i është referuar dispozitave normative, akteve ligjore e nënligjore në fuqi, rrethanave, fakteve dhe provave të palës së paditur Fondi. Gjukata nuk e ka shqyrtuar ligjshmërinë e çështjes, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën konkrete.

Gjukata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr.49/2012 “Për gjukatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, me vendimin e datës 03.05.2018 ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018 dhe rrëzimin e kërkesë padisë, për këto arsye:

- Ky vendim është i pabazuara në ligj dhe në prova, dhe ky vendim duhet ndryshuar duke vendosur rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në prova dhe ligj.
- Kërkesë padia e palës paditëse [REDAKTUAR] dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit atakon momente kyçe ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën administrative dhe ligjore të financimit nga Fondi.

- Pala paditëse nuk ka respektuar rrugën administrative të sanksionuar për përfitimin e financimit të paketës së shërbimit shëndetësor të implantit koklear nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Pala paditëse nuk ka respektuar procedurën ligjore për përfitimin e paketës së shërbimit shëndetësor të implantit koklear nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
- Përcaktimi i palëve ndërgjyqëse ku si palë e paditur është përcaktuar Fondi, është i pambështetur në ligj. Në bazë të nenit 161, të Kodit të Procedurës Civile, padia mund të ngrihet bashkërisht kundër shumë të paditurve (bashkëndërgjyqës) në rast se kanë detyrime të përbashkëta mbi objektin e padisë. Në rastin në shqyrtim, Fondi nuk ka asnjë detyrim të përbashkët me palët e tjera të përcaktuara si palë e paditur, pasi në bazë të ligjit të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Fondi vetëm financon paketat e shërbimeve shëndetësore të cilat jepen dhe ofrohen nga institucionet shëndetësore, pa patur të drejtë të vendosë për përfitimin ose jo të tyre, as për sigurimin dhe vendosjen e aparateve, duke mos krijuar asnjë rrethanë ku mund të identifikohet diskriminimi i mundshëm.
- Në nenin 16, pika 1, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, citohet se: “Padia ndaj veprimit administrativ mund të ngrihet vetëm pas shterimit të ankimit administrativ”. Pretendimi i palës paditëse për ezaurim të ankimit administrativ është i pabazuar ligjërisht, pasi në organin më të lartë administrativ të Fondit nuk është paraqitur asnjë ankim administrativ mbi këtë çështje. Për këtë arsye ligjore, pala paditëse nuk legjitimohet të ngrejë padi ndaj Fondit.
- Fondi nuk ka patur asnjë kërkesë të drejtuar nga pala paditëse për të kryer veprim administrativ në Fond ose në drejtoritë në varësi të Fondit dhe si rrjedhim nuk ka refuzuar kryerjen e veprimit administrativ, dhe as nuk ka heshtur pasi nuk ka kërkesë të drejtuar për veprim administrativ. Në këto kushte padia e ngritur nga paditësi [REDACTED] dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit” është në kundërshtim me shkakun ligjor të ngritjes së padisë sipas nenit 17, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, ku citohet se: “Padia ngrihet për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë”. Në çështjen në shqyrtim, pala paditëse në asnjë rast nuk identifikon një refuzim apo heshtje në kryerjen e një veprimi administrativ nga Fondi.
- Në kërkesë padi, pala paditëse citon se: “VKM e cila ka hyrë në fuqi me datë 4 qershor 2014 paketa e shërbimit të implantit koklear (si një nga paketat falas për pacientët) financohet plotësisht si shërbim i rimbursueshëm nga ky Fondi dhe përfshin sigurimin e pajisjes së implantit koklear, si dhe procedurën kirurgjikale për vendosjen e tij në veshin e fëmijëve”. Ky pretendim është i pabazuar ligjërisht, pasi Fondi financon procedurën kirurgjikale të vendosjes së implantit koklear, vetëm pasi ndërhyrja kirurgjikale e vendosjes të jetë kryer nga institucioni shëndetësor publik. Aparatura e implantit koklear sipas standardeve të Bashkimit Evropian, sigurohet në çdo rast nga Ministria e Shëndetësisë.
- Kërkesat e paraqitura nga pala paditëse çënojnë parimin e sigurisë juridike, i cili përbën bazën e shtetit ligjor. Në asnjë rast nuk mund të kërkohet përmbushja e detyrimeve të administratës shtetërore pa zbatuar dhe respektuar ligjet mbi të cilin funksionon ajo. Pala paditëse nuk ka zbatuar kërkesat e legjislacionit lidhur me procedurat për përfitimin e kujdesit shëndetësor. Deklarimi fajtor i organit të administratës dhe caktimi i dëmshpërblimit lidhur me të çënon një interes më të madh

publik, që sanksionohet me tërësinë e ligjeve dhe Kushtetutës në Republikën e Shqipërisë. Fondi i cili nën parimin e barazisë dhe të solidaritetit përgjigjet për mbulimin e nevojave për të gjithë të siguarit e skemës së sigurimeve shëndetësore. Çdo disponim tjetër është antiligjor dhe i papranueshëm sepse cënon parimet bazë të skemës së sigurimeve shëndetësore të transparencës së kontributeve dhe përfitimeve.

- Në asnjë rast Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nuk ka diskriminuar dhe nuk ka shkaktuar dëm shëndetësor ndaj fëmijës së mitur [REDACTED]
- Në faqen 26 dhe 27, të vendimit, gjykata shprehet se: "Gjykata vlerëson se në rastin konkret, objekt gjykimi, "Mosveprimi administrativ i realizuar nga palët e paditura në mënyrë solidarë është shkaku i drejtpërdrejtë, i cili ka shkaktuar diskriminim për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar të të miturit [REDACTED], si dhe njëkohësisht dëmtimin e shëndetit të të miturit. Dëmi shëndetësor është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe me faj, si rezultat i mosveprimit të palëve të paditura Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Qendrës Shëndetësore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për sigurimin dhe vendosjen e aparaturës së implantit koklear. Në këtë kuadër palët e paditura janë të detyruara të shpërblejnë dëmin e shkaktuar në shëndetin e të miturit në formën e reduktimit dhe humbjen e aftësisë për të rikuperuar dëgjimin, për shkak të munsesës së aparaturës së implantit koklear, vendosjes së saj në mënyrë kirurgjikale tek i mituri [REDACTED] si dhe të shpenzimeve që janë bërë për të deri tani për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar".
- Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi në asnjë moment nuk konstatohet një mosveprim të Fondit, pasi VKM-ja nr. 308, datë 21.05.2014, nuk e ngarkon Fondin me përgjegjësi për sigurimin dhe për vendosjen kirurgjikale të aparaturës së implantit koklear tek i mituri.
- Në faqen nr. 28, të vendimit, gjykata shprehet se: "Gjykata vlerëson se në rastin objekt gjykimi, diskriminimi i të miturit nuk është shkaktuar nga ligji, pasi ky i fundit dhe akti nënligjor përkatës VKM nr. 308, datë 21.05.2014 e njeh trajtimin e diferencuar të komunitetit të të miturve me probleme të rënda dëgjimi dhe parashikon për ta ofrimin falas të paketës së implantit koklear, por diskriminimi rezulton të jetë nga sjellja dhe mosveprimi administrativ i palëve të paditura për të trajtuar ndryshe kategori të caktuara ku bën pjesë i mituri, në zbatim të VKM nr. 308, datë 21.05.2014, që detyron organet përgjegjëse shtetërore për sigurimin dhe vendosjen falas për pacientët e sëmurë të aparaturës së implantit koklear".
- Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi në asnjë moment nuk konstatohet një mosveprim të Fondit, pasi VKM-ja nr. 308, datë 21.05.2014, nuk e ngarkon Fondin me përgjegjësi për sigurimin dhe për vendosjen kirurgjikale të aparaturës së implantit koklear tek i mituri.
- Gjykata shprehet se: "Mohimi ka ardhur për shkak se, pala e paditur Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka siguruar implantin koklear, ndërkohë që Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, nuk ka kryer vlerësimin paraprak të gjendjes shëndetësore në zbatim të vendimit nr. 88, datë 09.07.2014, të Këshillit Administrativ të Fondit dhe udhëzimit nr. 26, datë 07.11.2014, si dhe ndërhyrjen kirurgjikale për vendosjen e tij, ndërkohë që pala e paditur Fondi nuk ka financuar, administruar dhe monitoruar ofrimin e paketës falas të shërbimit të implantit koklear". Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi Fondi e ushtron veprimtarinë e tij vetëm në respektim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Fondi nuk mund të financonte në rastin konkret, për sa kohë që nuk është zbatuar rruga administrative dhe ligjore e sanksionuar për përfitimin e financimit të

paketës së shërbimit shëndetësor nga Fondi. Fondi nuk mund të financonte për përfitim të paketës së shërbimit të implantit koklear, për sa kohë që i mituri nuk është referuar nga shërbimi mjekësor i ORL-së i QSUT-së, pranë Zyrës së Sektorit të Regjistrimit Kombëtar të Paketave të Fondit, sipas procedurës dhe dokumentacionit të sanksionuar. Shërbimi i ORL-së i QSUT-së nuk ka lëshuar për paditësin dokumentacionin mjekësor të kërkuar, si vendimin e konsultës së shërbimit dhe formularin e prioritetit të trajimit, sikurse dëshmohet me shkresën nr. 843/10 prot, datë 18.7.2017, të shërbimit të ORL-së dhe sikurse konfirmohet më shumë se një herë edhe nga vetë gjykata. Për sa kohë që i mituri nuk është referuar dhe nuk figuron i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Paketave për të përfutur paketën sipas VKM-së nr. 308, datë 21.05.2014, nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore Fondi. Administrimi dhe monitorimi i procedurave të regjistrimit të pacientëve që përfitojnë shërbimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që financohen nga Fondi në institucionet shëndetësore publike të kontraktuara me Fondin, bëhet vetëm në përputhje me VKA-në nr. 88, datë 09.07.2014 dhe udhëzimin nr. 26, datë 07.11.2014.

- Gjykata shprehet se: *"Sipas shkresës nr. 1513/1 prot, datë 22.04.2016 të Ministrisë së Shëndetësisë drejtuar shoqatës "Together for Life", rezultoi se Ministria e Shëndetësisë nuk e ka siguruar aparaturën e implantit koklear, për rrjedhojë implanti nuk është realizuar. Provohet qartë se gjatë këtij gjykimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka argumentuar dhe nuk ka sjellë asnjë provë konkrete apo dokumentacion zyrtar që të vërtetojë të kundërtën, se ky institucion ka zhvilluar procedurat e nevojshme ligjore dhe ka siguruar pajisjen e implantit koklear, sipas standardeve të BE-së, sikurse sanksionohet në shtojcën nr. 5, të VKM nr. 308, datë 21.05.2014. Gjykata vlerëson se për shkak së pala e paditur Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk ka marrë asnjë masë sipas detyrimeve, që burojnë nga VKM-ja e sipërcituar për sigurimin e implantit koklear për të miturin, pasoja ka ardhur dhe është rënduar."* Për sa konstatohet më lart, është totalisht e pabazuar në ligj dhe prova, qëndrimi i gjykatës për ta ngarkuar Fondin me përgjegjësi ligjore në këtë proces. Sikurse, është totalisht e pabazuar në ligj dhe prova detyrimi solidar i Fondit për të dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar në shëndetin e të miturit, prej palëve të tjera të paditura.
- Gjykata shprehet se: *"Me urdhrin nr. 258, datë 16.06.2014 "Për miratimin e protokolleve të paketave të shërbimeve që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor", të Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilën është miratuar edhe Protokollin e Implantit Koklear, në pikën 2 të tij ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për përzgjedhjen e ofertuesve të shërbimeve, me të cilët do të kontraktohet si dhe ndjekjen e zbatimit të protokolleve të sipërcituara. Për rrjedhojë rezultoi e provuar se akti nënligjor VKM nr. 308, datë 21.05.2014 ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sigurimin e pajisjes së implantit koklear, kjo e fundit me anë të urdhrin të mësipërm ia kalon përgjegjësinë për të përzgjedhur ofertuesit e shërbimeve dhe zbatimin e protokolleve përkatëse, Fondit. Gjatë gjykimit provohet se nga Fondi nuk është paraqitur asnjë provë që të vërtetojë se ka përzgjedhur ofertuesit e shërbimeve dhe ka zbatuar protokollin përkatës në rastin konkret për të provuar që sjellja e tyre nuk ka shkaktuar diskriminim".* Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me një delegim të përgjegjësisë për sigurimin e aparaturës të implantit koklear nga Ministria tek Fondi, por kemi të bëjmë me përgjegjësinë për përzgjedhjen e ofertuesve të shërbimit. Pra, të dhënësve të shërbimit shëndetësor publik dhe jopublik (d.m.th. të spitaleve, të cilat si ofertues të shërbimit ofrojnë shërbimin shëndetësor të vendosjes kirurgjikale të

aparaturës së implantit koklear). Në pikën 3, të VKM-së nr. 308, datë 21.05.2014, përcaktohet se: "Kontraktimi me institucionet publike dhe private për financimin e shërbimeve shëndetësore të paketave të mësipërme bëhet në përputhje me legjislacionin e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor". Në rastin konkret, sikurse ngarkohet edhe nga vetë VKM nr. 308, datë 21.05.2014, Fondi ka përzgjedhur ofertuesit e shërbimit dhe i ka kontraktuar ato, ku ndër këta ofertues është edhe QSTU-ja, një spital publik i kontraktuar me Fondin (sikurse dëshimohet me kontratat S/2016 dhe S/2017, të depozituara dhe administruara si prova nga gjykata), i cili ofron shërbimin e vendosjes kirurgjikale të implantit koklear dhe zbaton protokollin e miratuara. Për këtë arsye, sjellja e Fondit nuk ka shkaktuar diskriminim dhe përgjegjësia për sigurimin e aparaturës së implantit koklear në përputhje me standardet e BE-së, në çdo rast është e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Gjykata shprehet se: "Sikurse pranohet nga vetë Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndër dokumentet bazë për të përfutur paketën e implantit koklear është edhe dokumenti autorizues për kryerjen e shërbimit që lëshohet nga zyra e autorizuar e Fondit. I mituri [redacted] apo prindërit e tij duhet të pajisen me këtë dokument nga njëri nga ofruesit e shërbimit që është Fondi. Po ashtu edhe dokumentet e tjera që trajtohen në pikën 24 të këtyre prapësimeve si vendimi i konsultës së shërbimit përkatës, formulari i prioritetit të trajtimit, vendimi i konsultës së shërbimit të urgjencës, për të miturin [redacted], formulari i informacionit të përditësuar mbi kapacitetet e lira për çdo paketë shërbimi janë dokumente që lëshohen nga ofruesit e shërbimit të paketës së implantit koklear. Gjykata çmon se këto dokumente duhet të ishin hartuar dhe lëshuar në momentin që mjekët e Shërbimit ORL pranë QSUT kanë konstatuar dhe cilësuar të miturin si kandidat për implant koklear dhe si të vetmen zgjidhje shkencore për trajtimin e problemit të tij në dëgjim. Përgjegjësia ligjore për lëshimin e dokumenteve të mësipërme mjekësore dhe teknike që janë pjesë e procedurës dhe protokollit të ofrimit të paketës së shërbimit të implantit koklear nuk i takon të miturit apo prindërve të tij, por është e palëve të paditura Fondit dhe QSUT-së". Sërisht, qëndrimi i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi Fondi ligjërisht nuk ngarkohet të lëshojë dokumenta mjekësore. Përkundrazi, nëse i mituri [redacted] do të ishte referuar si kandidat për implant koklear nga shërbimi i ORL-së pranë QSUT-së, përmes lëshimit të dokumentacionit mjekësor pranë Zyrës së Sektorit të Regjistrimit të Paketave të Fondit dhe regjistrimit të tij në Regjistrin Kombëtar të Paketave, bazuar në këto dokumente vetëm atëherë Fondi do duhej të lëshonte dokumentacionin teknik si dokumentin autorizues. Për këtë arsye, Fondi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore për mos hartimin dhe mos lëshimin e dokumentacionit mjekësor, në momentin që shërbimi i ORL-së pranë QSUT-së kanë konstatuar dhe cilësuar të miturin si kandidat për implant koklear.
- Gjykata shprehet se: "Gjykata çmon se, palët e paditura edhe pasi janë vënë në dijeni zyrtarisht përmes ankimit të mësipërm dhe më pas, pas paraqitjes së kërkesë padisë përmes kësaj gjykate, megjithëse kishin mundësinë për të vepruar administrativisht duke u përcjellë edhe gjithë dokumentacionin provues organeve kompetente, ato nuk kanë reaguar apo njoftuar respektivisht njëra tjetrën për trajtimin dhe ndjekjen e rastit konkret të paraqitur para tyre, në zbatim të kuadrit ligjor dhe protokolleve përkatëse mjekësore. Rezulton e provuar se asnjë prej këtyre tre institucioneve të kujdesit shëndetësor publik nuk ka patur reagim, veprim administrativ apo përgjegjje dhe ky mosveprim administrativ i ngarkon këto institucione me përgjegjësi ligjore për pasojën e ardhur në shëndetin e të miturit G.L". Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi fillimisht Fondi nuk është një institucion i kujdesit

shëndetësor por në bazë dhe për zbatim të nenit 13, të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 të ndryshuar, Fondi është i vetmi person juridik publik autonom, i cili ofron dhe administron sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë. Fondi menaxhon skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në përputhje me politikat kombëtare të kujdesit shëndetësor, të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë. Gjithashtu, Fondi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore për mosreagim apo njoftim respektiv të njëra tjetrës, në një kohë kur ankimi administrativ i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila nuk i ka kthyer përgjigje brenda afateve ligjore sikurse konstatohet nga vetë gjykata. Gjithashtu, Fondi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore për sa kohë që në shqyrtimin gjyqësor të kërkesë padisë ka depozituar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore tek të cilat bazohet veprimtaria e tij ligjore. Në të njëjtën kohë, Fondi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore për mosveprim administrativ, për sa kohë që rezulton se ai është i ndërvarur ligjërisht nga veprimi administrativ i palëve të tjera të paditura, të cilat rezultojnë se nuk kanë vepruar administrativisht.

- Gjykata shprehet se: *“Gjykata gjen të pabazuar dhe prapësimin e përsëritur të Fondit se, qëndrimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi sipas shkresës nr. 133/1 prot, datë 16.02.2017 është i njëanshëm dhe ka marrë të mirëqenë pretendimet e paditësit. Gjykata vlerëson se në qëndrimin e tij zyrtar si një institucion i pavarur dhe i specializuar për ndalimin e diskriminimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bazuar jo në pretendimet, por në provat e paraqitura nga paditësi ku bën pjesë edhe shkresa nr. 1329/1 prot, datë 23.03.2016 e Fondit, me të cilën pohohet se Fondi financon procedurën kirurgjikale të vendosjes së implantit koklear, ndërsa aparatura e implantit koklear sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë. Lista e përfituesve administrohet nga shërbimi përkatës në QSUT, i cili përcakton kriteret mjekësore për përfitimin e kësaj pakete shëndetësore, si dhe në provat e tjera të lëshuara nga palët e paditura të cituara më sipër”*. Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi dëshmohet qartësisht se shpjegimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i njëanshëm, pasi sikurse pohohet nga vetë gjykata, këto shpjegime janë bazuar në provat e depozituara nga paditësi. Është detyrim ligjor i gjykatës të sigurojë një hetim gjyqësor nga fillimi dhe të plotë, në rastin kur çështja gjyqësore i caktohet një tjetër trupi gjykues. Për një hetim të plotë gjyqësor, shpjegimi i Komisionerit duhej të bazohej tek të gjitha provat e paraqitura nga palët e paditura, deri përpara seancës së parë gjyqësore.
- Gjykata shprehet se: *“Gjatë gjykimit eksperti i licencuar i kërkuar nga palët paditëse dhe i caktuar nga gjykata ka bërë llogaritjen e dëmit të shkaktuar të miturit, bazuar në detyrat e lëna po nga gjykata” në provat e paraqitura në dosje si dhe në vendimin unifikues nr. 12, datë 14.09.2007, të Gjykatës së Lartë. Eksperti i është përgjigjur me shkrim edhe pyetjeve specifike që kanë bërë palët ndërgjyqëse për çështje të ndryshme lidhur me këtë akt”*. Në këtë qëndrim gjykata nuk trajton aspak kundërshtitë e Fondit dhe palëve të tjera të paditura lidhur me akt vlerësimin dhe akt vlerësimin shtesë të hartuara nga eksperti, por i konsideron këto akte të mirëqena dhe të bazuara në ligj. Në një kohë që rezulton se këto akte janë të pabazuara në ligj dhe në prova, si dhe bien në kundërshtim me njëra tjetrën apo në mos përcaktimin e saktë të bazës ligjore të përdorur nga eksperti në hartimin e këtyre akteve apo edhe në mostrajtimin nga eksperti të qëndrimit zyrtar të shefit të shërbimit të ORL-së përmes shkresës nr. 843/10 prot, datë 18.07.2017.
- Gjykata shprehet se: *“Në këtë raport, pas përshkrimit të ekzaminimit të të miturit [redacted] me metoda eksperimentale dhe analiza laboratorike konkludohet: “Otoskopi normale, ABR-pa valë të pesta billateralisht deri në 90 Db, Nhl, Timpanograma tip A, normale*

billateralisht, pa reflex stepedien (SR) billateralisht". Në qëndrimin e saj gjykata nuk shprehet nëse janë kryer të gjitha ekzaminimet mjekësore, konform protokollit të paketës së implantit koklear të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë. Në shkresën e sipërcituar, shefi i shërbimit të ORL-së pranë QSUT-së shprehet se i mituri nuk i ka kryer të gjitha ekzaminimet e kërkuara.

- Gjykata shprehet se: *"Ndryshe nga sa është prapësuar nga palët e paditura, shkelja e ligjit apo fakti i diskriminimit të të miturit nuk ndikohet nëse shkaku ligjor i diskriminimit, që është aftësia e kufizuar e të miturit është patologji e lindur apo ka ardhur pas lindjes së tij"*. Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi qëndrimi i Fondit dhe i palëve të tjera të paditura ka të bëjë me dëmin e shkaktuar ndaj të miturit, i cili sikurse pohohet nga vetë eksperti ka lindur me një patologji të rëndë, shurdhësi në të dy veshët. Ku fatkeqësisht edhe vendosja e aparateve konvencionale të dëgjimit nuk kanë sjellur përmirësime. Fillimisht edhe vetë eksperti ka mbajtur një qëndrim refuzues lidhur me dëmin e shkaktuar nga palët e paditura, duke konstatuar faktin e patologjisë së lindur të të miturit.
- Gjykata shprehet se: *"Me shkresën nr. 608/1 prot, datë 04.07.2017 "Përgjigje mbi kërkesën për informacion zyrtar" të Fondit, është konfirmuar se, për përfitimin e paketës së shërbimit të implantit koklear të përcaktuar në VKM nr. 308, datë 21.05.2014, nuk rezulton asnjë pacient i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Paketave. Gjykata vlerëson se pacientët sikurse është i mituri [redacted] i cilësuar si kandidat për implantin koklear nga shërbimi i ORL-së, nuk mund të regjistrohet për ndërhyrje kirurgjikale pranë spitalit pa patur edhe dokumentin autorizues për kryerjen e shërbimit që lëshohet nga zyra e autorizuar e Fondit, vendimi i konsultës së shërbimit të QSUT-së etj. Por, këto dokumente mjekësore dhe administrative lëshohen nga shërbimet dhe zyrat përgjegjëse që ndodhen pranë palëve të paditura, përkatësisht pranë QSUT-se dhe Fondit"*. Ky qëndrim i gjykatës është i pabazuar në ligj e prova dhe nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi ligjore Fondin në këtë çështje gjyqësore, pasi fakti se nuk rezulton ndonjë pacient i regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Paketave, nuk vjen për faj të drejtëpërdrejtë dhe të paligjshëm të Fondit, por vjen për shkak se, shërbimi i ORL-së pranë QSUT-së nuk ka lëshuar dokumentet mjekësore dhe nuk ka referuar pacientët sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi (këtë qëndrim ka mbajtur kjo gjykatë në arsyetimin e këtij vendimi). Edhe për mosregjistrimin e të miturit [redacted] nuk mund të mbaj përgjegjësi ligjore Fondi, për sa kohë që sikurse konstaton edhe vetë kjo gjykatë, shërbimi i ORL-së pranë QSUT-së nuk ka lëshuar dokumentet mjekësore dhe nuk ka bërë referimin pranë Zyrës së Sektorit të Regjistrimit të Paketave të Fondit. Lidhur me pamundësinë sipas gjykatës, të të miturit për t'u regjistruar për ndërhyrje kirurgjikale pranë spitalit pa patur dokumentin autorizues, shprehemi se nuk është faj i drejtëpërdrejtë dhe i paligjshëm i Fondit që shërbimi i ORL-së pranë QSUT-së nuk ka lëshuar vendimin e konsultës, formularin e prioritetit të trajtimit etj.
- Në pikën 3 të pjesës urdhëruese të vendimit, gjykata shprehet se: *"Detyrimin e palëve të paditura që solidarisht të marrin masat për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese përmes riparimit të shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura: a) kryerjes së veprimeve administrative për sigurimin dhe vendosjen...; b) kompensimin e dëmit në formën e dëmtimit të shëndetit në masën 6.838.590 lekë"*. Ky qëndrim është i pabazuar në ligj dhe prova, pasi Fondi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore. Në rastin konkret Fondi nuk i ka shkaktuar paditësit një dëm në personin ose në pasurinë e tij. Fondi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore as për mos sigurimin e aparaturës së implantit koklear (VKM-ja nr. 308, datë 21.5.2014, këtë përgjegjësi ligjore ia ngarkon në çdo rast Ministrisë së Shëndetësisë), as për

moskryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale të vendosjes së kësaj aparature (VKM-ja, VKA-ja, udhëzimi dhe kontratat S/2016 dhe S/2017, këtë përgjegjësi ligjore ia ngarkojnë QSUT-së si ofertues i shërbimit të implantit koklear) dhe as për mosreferim të pacientit nga shërbimi i ORL-së të QSUT-së. Pra, Fondi nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi ligjore të shpërblimit të demit të shkaktuar, nëse persona të tjerë juridik, në mënyrë të paligjshme dhe me faj i kanë shkaktuar të miturit një dëm

- Neni 609/1, të Kodit Civil ku citohet se: *“Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personi”*. Në rastin konkret, këto rrethana ligjore nuk ekzistojnë, pasi Fondi nuk i ka shkaktuar ndonjë dëm paditësit, qoftë me veprim apo mosveprim. Të miturit nuk i është shkaktuar dëm si rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit apo mosveprimit të Fondit.
- Mbi detyrim të Fondit të dëmshpërblejë paditësin për dëmin jashtëkontraktor me pretendimin se, dëmi ka ardhur si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme të të paditurit Fondit, edhe ky kërkim i paditësit nuk gjen mbështetje në ligj dhe në prova, për arsye se në analizë të dispozitave ligjore të nenit 608 e 609, të Kodit Civil, që të lindin detyrime nga shkaktimi i demit jashtëkontraktor duhet të konkurojnë disa kushte së bashku, këto janë: a) ekzistenca e demit; b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit; c) ekzistenca e fajit, dhe ç) ekzistenca e lidhjes shkakore midis veprimit ose mosveprimit dhe demit të ardhur. Dëmi duhet të jetë rrjedhim i drejtëpërdrejtë dhe i menjëhershëm i veprimit ose mosveprimit të personit.
- Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjesisë për dëmin e shkaktuar është edhe lidhja shkakore që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe demit të shkaktuar. Lidhja shkakore paraqet raportin e ndërsjellë, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe demit, në të cilin veprimi i dëmshëm d.m.th, pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron autorin e saj, në rastin konkret organin administrativ, të shpërblejë dëmin plotësisht (qëndrim ky i unifikuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi unifikues nr. 12, datë 14.09.2007).
- FSDKSH ka hartuar me vendimin nr. 88, datë 09.07.2014 *“Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrit Kombëtar të Paketave të Financuara nga Fondi”*, të ndryshuar, të Kryetarit të Këshillit Administrativ, në të cilin përcaktohen rregullat kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrit Kombëtar të Paketave të financuara nga Fondi, si dhe udhëzimin nr. 26, datë 07.11.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH *“Për adiministrimin e Regjistrit Kombëtar të Paketave”*.
- Në pjesën urdhëruese të vendimit, pika 7, gjykata shprehet se: *“Ekzekutimi i këtij vendimi në lidhje me masën e kompensimit financiar të bëhet pranë zërit buxhetor të FSDKSH brenda 1 viti nga marrja e këtij vendimi formë të prerë”*. Ky qëndrim është totalisht i pabazuar në ligj dhe prova, pasi nuk gjen mbështetje ligjore fakti që kompensimi i demit në formën e dëmtimit të shëndetit të jetë përgjegjësi e Fondit dhe se ky dëm të jetë shkaktuar nga drejtëpërdrejtë dhe vetëm nga Fondi.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr.49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* i ndryshuar, me vendimin e datës 03.05.2018 ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, në të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018 dhe rrëzimin e kërkesë padisë, për këto arsye:

- Arsyet për të cilat e kundërshtojmë vendimin e Gjykatës Administrative Tiranë janë si vijon:
- Pretendimet e ngritura nga pala paditëse janë të pabazuar në prova dhe fakte. Në provat e vendosura në dispozicion të gjykatës mungojnë e gjithë procedura që duhet të ndjekë një pacient për të vendosur implantin koklear. Bazuar në provat e paraqitura nga paditësi nuk mund të kërkohej shpërblimi i dëmit pa provuar faktin se pacienti [REDAKTUAR] është kandidat për vendosjen e implantit koklear. Nuk ka një vendim konsulte për pacientin nëse është kandidat për vendosjen e implantit koklear. Gjithashtu në provat e paraqitura nga pala paditëse mungojnë ekzaminimet e për të përfituar statusin kandidat.
- Pala paditëse pretendon se është diskriminuar nga mosveprimi i organit publik QSUT, për këtë kërkoi nga gjykata ndër të tjera dhe konstatimin e diskriminimit në formën e “Mohimit të një përshtatje të arsyeshme”. Bazuar në VKM nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Shëndetit Shëndetësor në shërbimin spitalor” është parashikuar kosto për vendosjen e implantit koklear, si dhe detyrimin e Ministrisë së Shëndetësisë të sigurojë sipas kushteve të BE-së aparaturën e impiantit koklear. Në këtë rast QSUT ka si detyrim vetëm vendosjen e aparaturës dhe jo sigurimin e saj. Paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë ku të vërtetojë se pacienti është paraqitur pranë QSUT me dokumentacionin përkatës dhe nga ana e QSUT është refuzuar dhënia e shërbimit. Pra, pacienti nuk është diskriminuar në asnjë rast nga ana e QSUT, në këto kushte nuk mund të pretendojë se ka diskriminim.
- Referuar VKM-së nr. 308, datë 21.05.2014 Bazuar në V.K.M 308 datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të Shërbimeve Shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Shëndetit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor” është parashikuar kosto për vendosjen e implantit koklear si dhe detyrimin e Ministrisë së Shëndetësisë të sigurojë sipas kushteve të BE-së aparaturën e impiantit koklear. Në këtë rast Q.S.U.T ka si detyrim vetëm vendosjen e aparaturës dhe jo sigurimin e saj. Paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë ku të vërtetojë se pacienti është paraqitur pranë Q.S.U.T me dokumentacionin përkatës dhe nga ana e Q.S.U.T është refuzuar dhënia e shërbimit. Pra, pacienti nuk është diskriminuar në asnjë rast nga ana e Q.S.U.T, në këto kushte nuk mund të pretendojë se ka diskriminim.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me urdhrin nr. 258, datë 16.06.2014 “Për miratimin e protokolleve të paketave të shërbimeve që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ka miratuar protokollin përkatës, konkretisht edhe protokollin e implantit koklear. Në pikën 2 të këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor për përzgjedhjen e ofertuesve të shërbimeve, me të cilët do të kontraktohet si dhe ndjekjen e zbatimit të protokolleve të sipërcituara.
- FSDKSH ka hartuar me vendimin nr. 88, datë 09.07.2014 “Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrimit Kombëtar të Paketave të Financuara nga Fondi”, të ndryshuar, të Kryetarit të Këshillit Administrativ, në të cilin përcaktohen rregullat kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrimit Kombëtar të Paketave të financuara nga Fondi, si dhe udhëzimin nr. 26, datë 07.11.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH “Për administrimin e Regjistrimit Kombëtar të Paketave”. Regjistri Kombëtar i Paketave të financuara nga FSDKSH është dokumenti shtetëror i mbajtur në formë

elektronike dhe fizike, ku pasqyrohen përfituesit e paketave të shërbimeve shëndetësore që financohen nga Fondi. Regjistri ka formën e një libri të hapur për çdo paketë shërbimesh shëndetësore, ai mbahet në zyrat e autorizuara të Fondit dhe administrohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Në pikën 5 të këtij vendimi, përcaktohen dokumentat bazë mbi të cilat kryhen veprimet në Regjistrin Kombëtar të Paketave në lidhje me pacientët janë: a) Vendimi i konsultës së shërbimit përkatës; b) Formulari i prioritetit të trajtimit; c) Karta e identitetit; d) Karta e shëndetit; e) Vendimi i konsultës së shërbimit të urgjencës.

- Dokumenti bazë që jepet nga dhënësit e shërbimit shëndetësor të kontraktuar me Fondin dhe mbi të cilin kryen veprime në Regjistrin Kombëtar të Paketave është formulari i informacionit të përditësuar mbi kapacitetet e lira për çdo paketë shërbimi. Dokumenti bazë që lëshohet nga zyra e autorizuar e Fondit për përfituesit e shërbimeve të paketave është dokumenti autorizues për kryerjen e shërbimit. Pacienti Gisel Leka nuk është paraqitur pranë QSUT-së me dokumentacionin e lartpërmendur për të përfituar shërbimin mjekësor. Ndaj në këto kushte nuk jemi përpara diskriminimit në formën e “Mohimit të një përshtatje të arsyeshme”.
- Në lidhje me aktin e ekspertimit të kryer nga eksperti, rezulton të jetë i pambështetur në provat e paraqitura në gjykatë. Eksperti ka bërë vetëm përlllogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror sipas vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 12, datë 12.09.2007, pa vlerësuar së pari nëse ka dëm ose jo. Në përfundim, eksperti ka përlllogaritur vlerën e dëmit pasuror dhe jo pasuror në total, pa përcaktuar dëmin e secilit prej të paditurve. Kjo e bën të pa qartë kërkimin e palës paditëse. Gjithashtu nga ana e ekspertit nuk është analizuar nëse pacienti ka kryer të gjitha procedurat për përfitimin e implantit koklear, ndaj kjo e bën të pavlefshëm dhe joreal aktin e ekspertimit. Vlerësimi i bërë nga eksperti duhet të bëhej pasi të ishte vërtetuar se pacienti ka fituar statusin kandidat për vendosjen e implantit koklear. Eksperti nuk është përgjigjur drejt pyetjeve shtesë të bëra nga pala e paditur QSUT, madje nga ana e ekspertit janë kthyer përgjigje me një fjali ç’ka e bën jo serioze analizimin e gjendjes së pacientit.
- Për të patur përgjegjësi civile në kuptim të nenit 608, të Kodit Civil, është e kërkueshme që veprimet/ mosveprimet të jenë bërë me faj. Ky rregull vlen qoftë për dëmin e shkaktuar nga mosekzekutimi i detyrimeve, qoftë për dëmin jashtëkontraktor. Në kuptimin juridiko-civil me “faj” do të konsiderojmë qëndrimin psikologjik të personit ndaj veprimit/ mosveprimit të tij dhe pasojave që mund të vijnë prej këtij veprimi/ mosveprimi. Pra, faji nënkupton ndërgjegjësimin e personit se veprimet/ mosveprimet e tij dhe/ ose pasojat e këtyre veprimeve/ mosveprimeve janë të paligjshme. Faji mund të jetë në dy forma, në “dashje” dhe në “pakujdesi”, dhe në detyrimet jashtëkontraktore faji duhet të jetë ose me dashje, ose me pakujdesi.
- Nisur nga ky përkufizim, rrethanat e faktit dhe provat e paraqitura në çështjen në hetim, nuk provohet që QSUT të ketë kryer veprim/ mosveprim me faj, si pasojë e të cilit t’i ketë shkaktuar ndonjë dëm paditësit, që të detyrohet të dëmshpërblejë. Paditësi nuk ka paraqitur asnjë provë apo dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.
- Në kuptim të nenit 609, të Kodit Civil, për të patur përgjegjësi juridiko-civile nuk mjafton vetëm ekzistenca e dëmit, por duhet të konkurojnë pra të shfaqen njëkohësisht elementët e mëposhtëm: a) Dëmi të ketë ardhur si pasojë e veprimeve/ mosveprimeve; b) Veprimet/ mosveprimet të jenë bërë me faj; c) Ndërmjet veprimeve/ mosveprimeve dhe dëmit të ketë lidhje shkakësore; d) Veprimet/ mosveprimet të jenë të paligjshme. Në kushtet kur nuk rezulton e provuar të kemi kryer veprime/ mosveprime me të cilat paditësit i është shkaktuar dëm, me ose pa faj apo në pakujdesi, çmujmë se dy elementët e parë të sipërcituar, për të patur

përgjegjësi juridiko-civile, janë inekzistente. Në vijim të kësaj analize, elementi i tretë dhe i domosdoshëm që duhet të ekzistojë për të patur përgjegjësi juridiko-civile, është dhe lidhja shkak pasojë. Nuk u paraqit në këtë gjykim asnjë provë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, e vlerësueshme lirisht apo ligjore që të vërtetonte lidhjen shkakësore midis cënimit të pretenduar në shëndetin e paditësit dhe ndonjë fakti të paligjshëm të kryer nga i padituri apo i punësuar pranë tij.

- Gjkata ka gabuar në dhënien e vendimit, duke mos marrë parasysh provat dhe prapësimet e paraqitura nga ana jonë, duke mos i vlerësuar ato si të mbështetura në ligj. I kërkojmë Gjykatës së Apelit Administrativ të vendosë rrëzimin e padisë, pasi vlerësimin për marrjen e statusit kandidat për vendosjen e implantit koklear vendoset me vendim konsulte dhe ky dokument nuk është paraqitur nga pala paditëse gjatë gjykimit. Ndaj gjykata ka gabuar në arsyetimin e saj, duke detyruar QSUT të ndreqë shkeljet ligjore dhe vendosjen e implantit koklear. Ashtu siç pala paditëse e pranoi por edhe nga akti i ekspertimit të bërë nga eksperti i caktuar gjatë gjykimit, doli qartë se vendosja e implantit koklear kërkon jo vetëm bërjen e analizave specifike sipas protokollit të caktuar, por edhe përshtatshmërinë e aparatit me femijën, ç'ka do të thotë se janë mjekët ata që japin vlerësimin nëse aparati do të jetë funksional apo jo tek fëmija.
- Nga shpjrgimet e ekspertit gjatë gjykimit, aparati është efektiv në rast se vendoset brenda moshës 4 vjeç, ndërkohë që fëmija [REDAKTUAR] e ka kaluar këtë moshë. Duam të sqarojmë Gjykatën e Apelit se mosvendosja e aparatit nuk është për faj të QSUT-së, por për neglizhencën e vetë palës paditëse, e cila nuk është paraqitur asnjëherë për ndjekjen e procedurave për përfitimin e statusit kandidat për vendosjen e implantit koklear. Arsyet e mospasjes së njohurive për ndjekjen e procedurave nuk vlejnjë, pasi në provat e paraqitura në gjykatë pala paditëse ka paraqitur kartelën për përfitimin e KEMP, kjo tregon qartë se në këtë rast pala paditëse ka ndjekur procedurat e kërkuara për përfitimin e ndihmës. Për rrjedhojë duam të theksojmë se nga ana e QSUT nuk ka asnjë sjellje diskriminuese ndaj dhe kompensimi në masën 6.838.590 lekë nuk gjen mbështetje ligjore dhe për këto arsye padia duhet të rrëzohet.

Gjkata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, me vendimin e datës 02.05.2018 ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim Avokatura e Shtetit pranë Ministrisë së Shëndetësisë, në të cilin ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 1250 (80-2018-1281), datë 10.04.2018 dhe rrëzimin e kërkesë padisë, për këto arsye:

- Vendimi është dhënë në kundërshtim me provat e administmara në këtë proces gjyqësor dhe në shkelje të ligjit.
- Referuar këtij kërkimi, çmojmë se ndodhemi përpara një padie për kërkimin e dëmit jashtëkontraktor në kuptim të nenit 608, të Kodit Civil, në kushtet kur midis palëve nuk ka ekzistuar ndonjë kontratë.
- Referuar dokumentit "Përmbledhje e daljes", datë 27.10.2015, të shërbimit ORL, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", për shkak të invaliditetit dhe paaftësisë është rekomanduar që i mituri Gisel Leka të trajtohet me KEMP, si dhe është cilësuar kandidat për CI ose për implant koklear. Referuar dokumentit tjetër "Fletë drejtimi për KEMP", datë 29.10.2015, të Komisionit Mjekësor të Shërbimit ORL, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, është rekomanduar që për mjekimin e problemit në dëgjim i mituri [REDAKTUAR] t'i nënshtrohet CI (implantit kockor).

- Sipas dokumenteve “Raporti mjekësor”, datë 31.10.2016, të Shërbimit të Kirurgjisë Infantile ORL pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, dhe “Raportit mjekësor”, datë 24.10.2016, të Departamentit të Otorinolaringologjisë në Spitalin “Hygeia” Tiranë, implantimi koklear (CI) është e zgjidhja për korigjimin e problemit në dëgjim .
- Referuar VKM-së nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, paketa e shërbimit të implantit koklear financohet plotësisht si shërbim i rimbursueshëm nga Fondi. Në listën e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shtojcën nr. 5 “Paketa e shërbimit të implantit koklear”: “Aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së, sigurohet në çdo rast nga MSH-ja”.
- Padiësi [REDAKTUAR] pretendon që është diskriminuar nga mosveprimi i organeve publike (përfshirë këtu dhe Ministrinë e Shëndetësisë) si dhe KSHH, si një shoqatë që pretendon që i është cënuar një interes i ligjshëm publik, i drejtohen gjykatës për të detyruar palët e paditura për konstatimin e diskriminimit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar përmes ndreqjes së shkeljeve ligjore dhe pasojave, duke kryer veprimet e nevojshme administrative për sigurimin dhe vendosjen e implantit koklear për fëmijën e mitur me probleme të dëgjimit [REDAKTUAR], si dhe kompensimin e dëmit jopasuror si dëm biologjik në masën 600.000 lekë.
- Sipas nenit 18 të Kushtetutës, të gjithë duhet të jenë të barabartë para ligjit. Kjo dispozitë në paragrafin e dytë sanksionon ndalimin e diskriminimit mbi baza gjinore, racore, feje, etnie, gjuhe, bindjeje politike, fetare e filozofike, gjendje ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësie prindërore, ndërsa paragrafi i tretë mishëron në vetvete kufizimin e kësaj të drejte, sipas të cilit askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin e dytë, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive. Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet jurisprudencës së saj, në disa vendime ka interpretuar nenin 18, të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në/ përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore. Konkretisht, ajo është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia para ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përlligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 39, datë 16.10.2007; nr. 4, datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).
- Sipas kërkuesve, shprehja “barrë të tepruar” në pikën 7, të nenit 3, të ligjit, i përkufizon në mënyrë të qartë veprimet e shtetit si një barrë për akomodimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara. Ky kufizim dhe përkufizim është vendosur vetëm për personat me aftësi të kufizuara dhe jo për grupet e tjera, nga ku del qartë se personat me aftësi të kufizuara trajtohen në mënyrë të diferencuar nga ligji, në raport me grupet e tjera të shoqërisë. Konstatohet se termi “përshtatje e arsyeshme” është zëbërthyer nga neni 2, i KPAK-ut, sipas të cilit “përshtatje e arsyeshme” do të thotë modifikim i nevojshëm dhe i duhur, apo përshtatje që nuk imponon barrë disproporcionale ose të tepruar në një çështje specifike, me qëllim për t’i siguruar personit me paafësi, gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore mbi baza barazie, njësoj si të tjerët. Sipas Gjykatës Kushtetuese, mungesa e kriterëve përcaktuese në ligj të “barrës së tepruar”, nuk krijon papajtueshmëri me Kushtetutën, pasi janë organet zbatuese dhe kontrolluese të respektimit të këtij ligji, të

cilat do të kenë mundësi të interpretojnë “përshtatjen e arsyeshme” rast pas rasti. Ky interpretim do të realizohet nga këto organe në varësi të natyrës së pretendimeve si dhe mundësisë për kryerjen e rregullimeve/ ndryshimeve të arsyeshme nga ana e subjektit, mbi të cilin bie detyrimi i përshtatjes dhe mbi të cilin nuk duhet imponuar barrë disproporcionale.

- Përsa i përket detyrimit të të paditurit, të dëmshpërblejë paditësin për dëmin jashtëkontraktor me pretendimin se është dëmi ka ardhur si rezultat i veprimeve/mosveprimeve të paligjshme të të paditurit edhe ky kerkim i paditësit nuk gjen mbështetje në ligji dhe në prova për arsye se:
- Në analizë të dispozitave ligjore nenit 608 e 609, të Kodit Civil, që të lindin detyrime nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor duhet të konkurojnë disa kushte së bashku, këto janë: a) ekzistenca e dëmit; b) ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose të mosveprimit; c) ekzistenca e fajit; d) ekzistenca e lidhjes shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe dëmit të ardhur. Një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar është edhe lidhja shkakësore që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Lidhja shkakësore paraqet raportin e ndërsjelltë, ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm d.m.th, pa të cilin ky dëm nuk do të kishte ndodhur, konsiderohet si një shkak dhe e detyron autorin e saj, në rastin konkret organin administrativ, të shpërblejë dëmin plotësisht (qëndrim ky i unifikuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi unifikues nr.12, datë 14.09.2007).
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me urdhrin nr. 258, datë 16.06.2014 “Për miratimin e protokollove e të paketave të shërbimeve që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor” të ministrit përgjegjës për shëndetësinë, ka miratuar protokollin përkatës, konkretisht edhe protokollin e implantit koklear. Në pikën 2 të këtij urdhri ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Fondit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor për përzgjedhjen e ofertuesve të shërbimeve, me të cilët do të kontraktohet si dhe ndjekjen e zbatimit të protokolleve të sipërcituara.
- FSDKSH ka hartuar me vendimin nr. 88, datë 09.07.2014 “Për rregullat, kriteret dhe mënyrën e organizimit të Regjistrit Kombëtar të Paketave të Financuara nga Fondi”, të ndryshuar, të Kryetarit të Këshillit Administrativ, në të cilin përcaktohen rregullat kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrit Kombëtar të Paketave të financuara nga Fondi, si dhe udhëzimin nr. 26, datë 07.11.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH “Për administrimin e Regjistrit Kombëtar të Paketave”. Regjistri Kombëtar i Paketave të financuara nga FSDKSH është dokumenti shtetëror i mbajtur në formë elektronike dhe fizike, ku pasqyrohen përfituesit e paketave të shërbimeve shëndetësore që financohen nga Fondi. Regjistri ka formën e një libri të hapur për çdo paketë shërbimesh shëndetësore, ai mbahet në zyrat e autorizuara të Fondit dhe administrohet sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim. Në pikën 5 të këtij vendimi, përcaktohen dokumentat bazë mbi të cilat kryhen veprimet në Regjistrin Kombëtar të Paketave në lidhje me pacintët janë: a) Vendimi i konsultës së shërbimit përkatës; b) Formulari i prioritetit të trajtimit; c) Karta e identitetit; d) Karta e shëndetit; e) Vendimi i konsultës së shërbimit të urgjencës.
- Dokumenti bazë që jepet nga dhënësit e shërbimit shëndetësor të kontraktuar me Fondin dhe mbi të cilin kryen veprime në Regjistrin Kombëtar të Paketave është formulari i informacionit të përditësuar mbi kapacitetet e lira për çdo paketë shërbimi. Dokumenti bazë që lëshohet nga zyra e autorizuar e Fondit për përfituesit e shërbimeve të paketave është dokumenti autorizues për kryerjen e shërbimit, (elektronikisht dhe manualisht). Emri i të mitur ██████████ nuk pasqyrohet në këtë

regjistër. Pra nuk mund të jetë subjekt i përfitimit të paketave të shërbimit shëndetësor që do të financohen nga FSDKSH.

- Për sa më sipër nuk jemi para diskriminimit në formën e “Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme” ndaj fëmijës [REDAKTUAR], sepse organet shtetërore kanë kryer të gjitha detyrimet ligjore përkatëse për të garantuar këtë gjë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë në respektim të kërkesave ligjore të neneve 46 dhe 48 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar, me vendimin e datës 03.05.2018 ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarës **Bernina Kondi**, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I.Rrethanat e çështjes:

Nga aktet bashkëngjitur dosjes që i përket vendimit objekt ankimi rezulton se, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (në vazhdim KSHH) është një organizatë jo fitimprurëse që ka në misionin e saj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Referuar statutit të KSHH, objekt i punës është vëzhgimi i gjendjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, zbatimi i parimeve të shtetit ligjor dhe denoncimi i çdo shkeljeje që bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe normat e së drejtës ndërkombëtare të njohura. Pjesë e punës së KSHH është dhe vëzhgimi i respektimit të të drejtave të komuniteteve të tjera dhe grupeve vunerabël, si femijët, gratë, etj, në Shqipëri, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Pranë zyrave të KSHH është paraqitur shtetasi Ajet Leka, në cilësinë e babait të fëmijës së mitur, të sëmurë [REDAKTUAR] i datëlindjes 04.02.2013, i cili është diagnostikuar si problem i lindur me “Hypoacusia bilateralis profunda surdomutisim”, ose shurdhësi e rëndë në të dy veshët.

Referuar dokumentit “Përmbledhje e daljes”, datë 27.10.2015, të Shërbimit O.R.L, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të invaliditetit dhe paaftësisë është rekomanduar që i mituri [REDAKTUAR] të trajtohet me KEMP si dhe është cilësuar kandidat për CI ose për implant koklear. Referuar dokumentit tjetër “Fletë drejtimi për KEMP”, datë 29.10.2015, të Komisionit Mjekësor të Shërbimit O.R.L, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, është rekomanduar që për mjekimin e problemit në dëgjim i mituri [REDAKTUAR] t’i nënshtrohet CI (implantit kokkor). Implanti Koklear (CI) është një aparaturë elektronike, e cila implantohet ose vendoset tek njeriu në mënyrë kirurgjikale dhe që mundëson dëgjimin tek një person i cili është plotësisht i shurdhër ose që ka një humbje të thellë të degjimit. Kjo aparaturë sjell zë apo tingull në veshin e paaftë për të degjuar.

Me vendimin nr. 27925, datë 17.12.2015, Komisioni Mjekësor i caktimit të aftësisë për punë Pogradec ka vendosur se i mituri [REDAKTUAR] e ka humbur aftësinë për punë në masën e Gr. 2 (ku klasifikohen shtetasit me humbje të dëgjimit), prej datës 17.12.2015 deri në datë 30.11.2016.

Sipas shkresës nr. 1329/1, datë 23.03.2016 "Përgjigje shkrese" të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor drejtuar shoqatës "Together for Life", konfirmohet se, Fondi financo procedurën kirurgjikale të vendosjes së implantit koklear, ndërsa aparatura e implantit koklear sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë. Lista e përfituesve administrohet nga shërbimi përkatës në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, i cili përcakton kriteret mjekësore për përfitimin e kësaj pakete shëndetësore.

Sipas shkresës nr. 1513/1, datë 22.04.2016 "Kthim përgjigje", të Drejtorisë së Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë drejtuar Shoqatës "Together for Life" rezulton se, Ministria e Shëndetësisë ka ngritur grup pune, i cili është duke punuar për të bërë studimin përkatës me qëllim përfshirjen e aparateve kokleare në listën e rimbursimit nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e cila do të jetë dhe mënyra e zgjidhjes përfundimtare të realizimit të implantit koklear.

Sipas dokumenteve, Raportit Mjekësor datë 31.10.2016, të Shërbimit të Kirurgjisë Infantile O.R.L pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, dhe Raportit Mjekësor datë 24.10.2016, të Departamentit të Otorinolaringologjisë në Spitalin Hygeia Tiranë, Implantimi Koklear (CI) është e vetmja zgjidhje për korrigjimin e problemit në dëgjim. Duke patur parasysh moshën aktuale të të miturit [REDAKTUAR] është sugjeruar që ndërhyrja kirurgjikale të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur.

Në bazë të VKM nr. 308, datë 21.05.2014, "Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor", e cila ka hyrë në fuqi në 04.06.2014, paketa e shërbimit të implantit koklear (si një nga paketat falas për pacientët) financohet plotësisht si shërbim i rimbursueshëm nga ky Fond. Ndërsa, aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së, sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Pasi është rekomanduar nga mjekët dhe për shkak të mungesës së veprimit të palës së paditur, paditësit [REDAKTUAR] dhe KSHH, përmes shkresës nr. 542-542/2, datë 16.11.2016 "Ankim ndaj mosveprimit administrativ për vendosjen e implantit koklear (CI) për pacientin e mitur me probleme të dëgjimit [REDAKTUAR] të KSHH, i janë drejtuar me ankim administrativ palës së paditur Ministria e Shëndetësisë, e cila nuk rezulton që të ketë kthyer përgjigje në lidhje me ankimin e paraqitur nga pala paditëse.

Paditësit duke mos qenë dakort me sa më sipër, për mbrojtjen e të drejtës së cënuar me datë 27.01.2017, i janë drejtuar gjykatës me padinë objekt gjykimi.

Gjatë gjykimit në shkallë të parë, gjykata bazuar në nenin 224/ të K.Pr.Civile dhe në nenin 25, të ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", për sqarimin e fakteve që kanë të bëjnë me këtë mosmarrëveshje nevojitet njohuri e posaçme nga fusha e vlerësimit të dëmit shëndetësor caktoi ekspertin Dr. [REDAKTUAR] i cili përgatiti aktin e ekspertimit datë 14.12.2017, sipas të cilit ndër të tjera theksohet se: "Max dëmi pasuror dhe jopasuror në interpretim të vendimit unifikues për [REDAKTUAR] - 2.279.530 + 4.559.060 = 6.838.590 lekë; Min dëmi pasuror dhe jopasuror në interpretim të vendimit unifikues për [REDAKTUAR] - 2.279.530 + 3.419.295 = 5.698.825 lekë." Ndërsa sipas aktit shtesë të ekspertimit datë 11.01.2018, eksperti ndër të tjera ka theksuar se: "Sipas Kartelës Klinike që ndodhet në dosje i mituri Gisel Leka ka ardhur për konsultë dhe caktimin e paaftësisë me rekomandimin e mjekut specialist ORL të Pogradecit. Pasi fëmija është konsultuar me mjekët specialistë të QSUT është shtruar në

spital, janë bërë të gjitha ekzaminimet që kanë të bëjnë me dëgjimin dhe në përfundim është arritur në konkluzionin se e vetmja zgjidhje për rehabilitimin e plotë të fëmijës është Implanti Koklear. Në dalje femija është pajisur me fletë drejtimi për në KMCAP, i cili përfiton grupin e dytë të invaliditetit. Ajo që është kryesore theksoj se vetë mjekët specialistë e kanë parë si të vetmen zgjidhje vendosjen e implantit koklear, pasi fëmija është shtruar në këtë spital në moshën më optimale, ku dhe efekti i vendosjes së implantit koklear do të ishte maksimal. Dëmi i shkaktuar pacientit Gisel Leka është mosvendosja e implantit koklear. Profesionimi im është pediatër i përgjithshëm, por mbështetur dhe në provat mjekësore që ndodhen në dosje si Kartela Klinike e shtrimit në spital, Raportit Mjekësor nga Shërbimi i Kirurgjisë Infantile, Raporti Mjekësor i Departamentit Otorinolaringologjisë së Spitalit [REDAKTUAR] nga Dr. Otoneurokirurg [REDAKTUAR] si dhe nga ekzaminimi objektiv që i kam bërë te miturit kam dalë në konkluzionin se femija është kandidat për implantin koklear. Patologjia që ka i mituri [REDAKTUAR] është një patologji e lindur. Dëmi që i është shkaktuar fëmijës ka ardhur si pasojë e mosvendosjes së implantit koklear. Baza ligjore që kam përdorur për hartimin e akt vlerësimit është cituar në faqen e dytë të aktit, ndërsa lidhur me masën e humbjes së aftësisë jam mbështetur në kriteret mjekësore për caktimin e aftësisë për punë në fushën e invaliditetit (miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtori i Përgjithshëm i ISSH). Në rastin konkret humbja e aftësisë tek i mituri [REDAKTUAR], duke përfituar grupin e II të invaliditetit është në masën mbi 67%”.

II. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Gjykata ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë me argumentimin si vijon:

Gjatë gjykimit të çështjes u provua se fëmija i mitur [REDAKTUAR] datëlindjes 04.02.2013 (në dosje çertifikata familjare datë 25.10.2016 dhe çertifikata e lindjes se të miturit datë 02.11.2016, të Njësisë Administrative Proptisht, Bashkia Pogradec), është diagnostikuar si problem i lindur me "Hypoacusia bilateralisprofonda, surdomutisim", ose shurdhësi e rëndë në të dy veshët.

Gjykata vlerëson se për shkak të moshës së mitur, fëmija [REDAKTUAR] gëzon mbrojtje të veçantë ligjore nga shteti. E drejta për t'u zhvilluar në shkallën më të madhe të mundshme e fëmijëve mbrohet dhe nga Konventa e OKB-së "Mbi të drejtat e fëmijës", (ratifikuar me ligjin nr. 7531, datë 11.12.1991). Shtetet palë njohin se, fëmija me paafësi mendore ose fizike duhet të bëjë një jetë normale dhe të përshtatshme, në kushte që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e tij aktive në jetën e bashkësisë (neni 23, pika 1, germa "b", të Konventës së OKB-së "Mbi të drejtat e fëmijës"). Po kështu, fëmijët me aftësi të kufizuar duhet të përfshihen në jetën e komunitetit, duhet të kenë akses dhe kushte të përshtatshme për arsimim, si dhe të gëzojnë lehtësira në lidhje me trajtimin e tyre shëndetësor.

Sipas tërësisë së provave të administruara në gjykim, rezulton se për shkak të sëmundjes së rëndë dhe paafësisë fizike, i mituri [REDAKTUAR] ka shfaqur mungesë të zhvillimit gjuhësor dhe mosreagim ndaj gjuhës së folur, duke iu mohuar kështu përshirja në jetën e komunitetit si dhe në gezimin e të drejtave të tjera, për rrjedhojë ndihet i diskriminuar dhe i braktisur. Ligji nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" ka si qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes si dhe përcakton përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qëndrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim

mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri (neni 2, germet "a" dhe "b", i ligjit). "Mohim i përshtatjes së arsyeshme" është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 3, pika 6, e ligjit).

Gjatë gjykimi rezultoi se, aftësia e kufizuar e të miturit [REDAKTUAR] është konstatuar nga Komisioni Mjekësor të Shërbimit ORL, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, të cilët kanë përcaktuar edhe domosdoshmërinë për vendosjen e implantit koklear. Gjykata çmon në këtë kuadër se është përgjegjësi ligjore e shtetit të sigurojë kushtet dhe mjeket e nevojshme për plotësimin e nevojave për shërbime dhe përkujdesje me qëllim minimizimin apo heqjen e pengesave për përfshirje si dhe për rritjen në maksimum të autonomisë dhe jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara.

Në aktet të tjera ndërkombëtare si Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Karta e të Drejtave Sociale Europiane, sanksionohet e drejta për kujdes mjekësor si pjesë e së drejtës së çdo njeriu "për një standart jetese për shëndetin dhe mirëqënien e tij dhe të familjes së tij" duke shtuar "nënat dhe fëmijët kanë të drejtë për kujdes dhe ndihmë të posaçme". Shtetet, palët angazhohen që për arritjen e gjendjes së mirë shëndetësore, të marrin masat e nevojshme për të siguruar profilaksinë dhe trajtimin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe të tjera, luftën kundër këtyre sëmundjeve, si dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për t'u siguruar të gjithëve shërbime mjekësore dhe një ndihmë mjekësore në rast sëmundjeje. Duke njohur të drejtën e mbrojtjes së veçantë ndaj rreziqeve fizike dhe morale ndaj të cilave ekspozohen, për fëmijët dhe adoleshentët, shtetet palë angazhohen për të parandaluar dhe zhdukur shkaqet që dëmtojnë shëndetin.

Gjykata vlerëson se, pavarësisht garancive kushtetuese dhe ligjore të cituara më sipër, për mbrojtjen shëndetit dhe kurimin e sëmundjes së të miturit [REDAKTUAR] i cili përfaqëson një komunitet të konsiderueshëm të të miturve me probleme të dëgjimit (çdo vit në vendi tonë lindin rreth 60-70 fëmijë me probleme të dëgjimit), nga palët e paditura është shkelur legjislacioni në fuqi, me pasoja të rënda për shëndetin e tij pasi ai rrezikon të mbetet i shurdhër sepse nuk i sigurohet mjekimi i përshtatshëm. Sipas dokumentit "Përmbledhje e daljes" dt.28.10.2015, pas shtrimit të pacientit [REDAKTUAR] për ekzaminim mjekësor pranë shërbimit O.R.L, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë (në dosje kopje e noterizuar), në periudhën 18.10.2015-27.10.2015, i lëshuar nga ky shërbim, për shkak të invaliditetit dhe paaftësisë shëndetësore që ka paraqitur është referuar që i mituri [REDAKTUAR] të trajtohet me KEMP si dhe është cilësuar si kandidat për CI ose për implant koklear. Ndërkohë që provohet se pas këtij vlerësimi shëndetësor, të shoqëruar me kryerjen e ekzaminimeve dhe analizave të posaçme lidhur me aftësinë e dëgjimit, me dokumentin "Fletë drejtimi për KEMP" të dt.29.10.2015, të komisionit mjekësor (të përbërë nga tre mjekë) të shërbimit O.R.L, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë për mjekimin e problemit në dëgjim në konkluzion është rekomanduar që i mituri t'i nënshtrohet CI (implantit koklear). Në këtë raport, pas përshkrimit të ekzaminimit të të miturit [REDAKTUAR] me metoda eksperimentale dhe analiza laboratorike konkludohet: "Otoskopi normale, ABR - pa valë të pesta bilateralisht deri në 90 DB NHL, timpanograma tip A normale bilateralisht, pa reflex stepedien (SR) bilateralisht".

Me vendimin nr. 27925, dt.17.12.2015, Komisioni Mjekësor i caktimit të aftësisë për punë Pogradec ka vendosur se i mituri [REDAKTUAR] e ka humbur aftësinë për punë në masën e Gr. 2 (ku klasifikohen shtetasit me humbje të dëgjimit), prej datës 17.12.2015 deri në datë

30.11.2016. Për periudhën 2016-2017 dhe në vazhdim, i mituri është ekzaminuar nga KMCAP Pogradec dhe po trajtohet sërish me KEMP.

Në vazhdim ai është protezuar me aparate dëgjimi konvencionale, si dhe i është nënshtruar terapisë logopedike intensive, por pas 6 muajve nuk është vërejtur progres në drejtim të zhvillimit gjuhësor. Në mungesë të efektivitetit të këtij mjekimi, ky shërbim i ka rekomanduar pacientit të mitur [REDAKTUAR] Implantimin Koklear (CI) si e vetmja zgjidhje për korigjimin e problemit në dëgjim.

Gjykata vlerëson se, referuar pikës 1, germa “d”, si dhe shtojcës 5, të VKM nr. 308, dt.21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, VKM e cila ka hyrë në fuqi në dt. 4 qershor 2014, paketa e shërbimit të implantit koklear (si një nga paketat falas për pacientët) financohet plotësisht si shërbim i rimbursueshëm nga ky Fond dhe përfshin sigurimin e pajisjes së implantit koklear, si dhe procedurën kirurgjikale për vendosjen e tij në veshin e fëmijëve, siç është i mituri [REDAKTUAR]. Nga pikëpamja teknike, kjo VKM përcakton se, aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së, sigurohet në çdo rast nga Ministria e Shëndetësisë. Po ashtu me Raportin Mjekësor dt.24.10.2016, të Departamentit të Otorinolaringologjisë në Spitalin Hygeia, Tiranë, konstatohet se korigjimi i problemit shëndetësor të të miturit [REDAKTUAR] i cili vuan nga Shurdhësi Neurosensoriale e Shkallës së Thellë mbetet vetëm Implantimi Koklear (CI), i cili duhet të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur duke marrë në konsideratë moshën aktuale (mosha optimale rreth 2 vjeç; mbi 4 vjeç reduktohen shanset për dëgjim optimal). Edhe pas mjekimit me proteza auditive konvencionale për një periudhë njëvjeçare, gjatë kësaj periudhë ai nuk ka zhvilluar të folur të asnjë shkalle. Vendosja në moshë të vogël e implantit koklear siguron ekspozimin e fëmijës ndaj tingujve. Kjo është shumë e rëndësishme pasi gjatë kësaj kohe fëmijët mësojnë të folur dhe aftësitë e tjera gjuhësore.

Gjykata çmon, se duke patur parasysh moshën e të miturit, i cili në dt.05.02.2018 ka mbushur moshën 5 vjeç, moskryerja e ndërhyrjes kirurgjikale për vendosjen e implanit koklear në një kohë sa më të shpejtë, siç kanë rekomanduar specialistët mjekë, aktualisht ka sjellë pasoja të rënda për mundësinë e dëgjimit të të miturit në të ardhmen edhe sikur kjo ndërhyrje të bëhet menjëherë. Gjykata vlerëson se mungesa e dëgjimit e privon atë edhe nga gëzimi i të drejtave të tjera si arsimimi, punësimi, aksesit në informacion, etj, duke shtuar pasojat e dëmshme jo vetëm të natyrës shëndetësore.

Provohet që nga koha kur të miturit [REDAKTUAR] i është rekomanduar vendosja e implantit koklear (CI) në vitin 2016, nga Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe në kushtet ku VKM nr. 308, dt.21.05.2014, detyronte sigurimin dhe vendosjen falas për pacientët të aparaturës së implantit koklear, nga ana e palës së paditur dhe deri tani nuk është kryer asnjë veprim për të siguruar pajisjen në fjalë, si dhe për kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale për të miturin. Sipas shkresës nr. 1513/1, dt.22.04.2016 “Kthim përgjigje”, të Drejtorisë së Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë drejtuar Shoqatës “Together for Life” rezulton se, Ministria e Shëndetësisë nuk e ka siguruar aparaturën e implantit koklear, akoma nuk është realizuar. Sipas shkresës nr. 1329/1, dt.23.03.2016 “Përgjigje shkrese” të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor konfirmohet se, Fondi financon procedurën kirurgjikale të vendosjes së implantit koklear, ndërsa aparatura e implantit koklear sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë. Lista e përfituesve administrohet nga shërbimi përkatës në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, i cili përcakton kriteret mjekësore për përfitimin e kësaj pakete shëndetësore.

Paditësit Ajet Leka dhe KSHH përmes shkresës nr. 542-542/2, dt.16.11.2016 “Ankim ndaj mosveprimit administrativ për vendosjen e implantit koklear (CI) për pacientin e mitur me probleme të dëgjimit [REDAKTUAR] të KSHH, kanë paraqitur ankim administrativ tek Ministria e Shëndetësisë, ndaj aktit administrativ ose mosveprimit të këtyre organeve publike

për sigurimin e implantit koklear dhe kryerjen e ndërhyrjes së specializuar kirurgjikale për të miturin [REDAKTUAR]. Në dosje ndodhen faqe të librit të protokollit të KSHH, ku rezulton dërgimi i ankimit në dt.16.11.2016 tek palët e paditura, si dhe kopje e dëftesës për pranimin e objekteve postare dt.17.11.2016, të Degës së Postës Shqiptare. Ministria e Shëndetësisë mund ta zgjidhte këtë ankim, duke nxjerrë një akt përfundimtar brenda 30 ditëve nga paraqitja e ankimit (nenet 138 dhe 140, të K.Pr.Administrative, nuk rezulton të ndërmarrë asnjë veprim lidhur me ndërmarrjen e ndonjë veprimi administrativ për sigurimin dhe vendosjen e implantit koklear (CI) për të miturin.

Gjykata gjen në situatën konkrete objekt gjykimi pretendimin e palës paditëse [REDAKTUAR] përfaqësues ligjor i fëmijës së mitur, se në rastin objekt gjykimi, kemi të bëjmë me "Mohim të një përshtatje të arsyeshme" ndaj të miturit [REDAKTUAR], mohim i cili është shfaqur në mosveprimet e palës së paditur, për të siguruar dhe vendosur aparaturën e implantit koklear tek i mituri. Provohet se shërbimi i O.R.L, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, si dhe specialistët e fushës së shëndetësisë kishin rekomanduar që prej dt.31.10.2016, që i mituri [REDAKTUAR] si e vetmja zgjidhje për korrigjimin e problemit në dëgjim t'i nënshtrohet ndërhyrjes kirurgjikale për vendosjen e CI (implantit koklear), se me kalimin e kohës vendosja e implantit është e paefektshme duke sjellë si pasojë invaliditetin e përhershëm si dhe detyrimeve ligjore (VKM nr. 308, dt.21.05.2014), për mjekimin e të miturit [REDAKTUAR], nga pala e paditur Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është bërë asnjë veprim për sigurimin e implantit koklear dhe kryerjen e ndërhyrjes së specializuar kirurgjikale tek i mituri.

Gjykata vlerëson se "Mosveprimi administrativ" i realizuar nga palët e paditura në mënyrë solidare është shkaku i drejtëpërdrejtë, i cili ka shkaktuar diskriminim për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar të të miturit [REDAKTUAR], si dhe njëkohësisht dëmtimin e shëndetit të të miturit. Dëmi shëndetësor është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe me faj, si rezultat i mosveprimit të palëve të paditura Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (neni 608/1 dhe neni 609/1, të Kodit Civil), për sigurimin dhe vendosjen e aparaturës së implantit koklear.

Gjykata vlerëson se i mituri [REDAKTUAR] ka të drejtë të dëmshpërblehet pasi ka pësuar një dëmtim të shëndetit të tij (neni 625, germa (a), i Kodit Civil). Në këtë kuadër palët e paditura janë të detyruara të shpërblejnë dëmin e shkaktuar në shëndetin e të miturit në formën e reduktimit dhe humbjes së aftësisë për të rikuperuar dëgjimin, për shkak të mungesës së aparaturës së implantit koklear, vendosjes e saj në mënyrë kirurgjikale tek i mituri Gisel Leka, si dhe të shpenzimeve që janë bërë për deri tani për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar (neni 641, i Kodit Civil).

Në vendimin unifikues nr. 12, dt.14.09.2007, të Gjykatës së Lartë është arritur në përfundimin se: "Dëmtimi i shëndetit (dëmi biologjik) përbën, në thelb, cënimin e së mirës së shëndetit, të integritetit fizik dhe/ ose psikik të njeriut. Ky dëm jopasuror, i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 625, të Kodit Civil, është objekt kërkimi dhe dëmshpërblimi i pavarur nga dëmi të tjera pasurore e jopasurore të pësuar nga i dëmtuari për shkak të të njëjtit fakt të paligjshëm. Meqënëse jeta dhe shëndeti i njeriut nuk ka çmim, në respektim të parimit themeltar kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe ndalimit të diskriminimit sipas nenit 18, të Kushtetutës, gjykata duhet të garantojë një gjykim uniform dhe vlerësim të njëjtë të përqindjes e të masës së dëmshpërblimit të dëmit biologjik, për çdo formë e shkallë konkrete të cënimit të përhershëm a të përkohshëm të integritetit fizik ose psikik të të dëmtuarit, nëse mosha është e njëjtë dhe po i njëjtë është edhe lloji i dëmtimit shëndetësor fizik a psikik të pësuar."

Sipas llogaritjes së ekspertit për dëmet shëndetësore, dëmi i shkaktuar të miturit [REDAKTUAR] është në masën 6.838.590 lekë (të reja).

Gjykata vlerëson se, në rastin konkret diskriminimi i të miturit Gisel Leka nuk është shkaktuar nga ligji, pasi ky infudnit është akt nënligjor VKM nr. 308, dt.21.05.2014 e njëh trajtmin e diferencuar të komunitetit të të miturve me probleme të rënda dëgjimi dhe parashikon për ta ofrimin falas të paketës së implantit koklear, por diskriminimi rezulton të jetë nga sjellja dhe mosveprimi administrativ i palëve të paditura, për të trajtuar ndryshe kategori të caktuara, ku bën pjesë i mituri [REDAKTUAR] në zbatim të VKM nr. 308, dt.21.05.2014, që detyron organet përgjegjëse shtetërore për sigurimin dhe vendosjen falas për pacientët e sëmurë të aparaturës së implantit koklear.

Gjykata çmon diskriminimi i të miturit ka ndodhur pikërisht për shkak të “Mohimit të përshtatjes së arsyeshme” që është shfaqur në formën e mohimit për të kryer rregullime të domosdoshme e të përshtatshme që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore për personat me aftësi të kufizuar.

Gjykata vlerëson se në rastin objekt gjykimi, duke provuar se i mituri është në gjëndje shëndetësore të tillë që duhet t’i sigurohet “përshtatja e arsyeshme” përmes vendosjes së implantit koklear, trajtimi i tij i diferencuar është i justifikuar madje i detyruar me ligj (VKM përkatëse).

Garantimi falas i paketës së shërbimit të implantit koklear miratuar me VKM nr. 308, dt.21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor” (hyrë në fuqi në dt. 4 qershor 2014), për të miturit me probleme të rënda të dëgjimit sikurse i mituri Gisel Leka, nuk përbën barrë të tepruar apo disproporcionale përderisa vetë shteti Shqiptar ka marrë përsipër mbulimin falas të këtij shërbimi .

Gjykata i gjen të pabazuara prapësimet e bëra nga Ministria e Shëndetësisë se mungon lidhja shkakësore për ardhjen e dëmit nuk është i bazuar. Diskriminimi i të miturit [REDAKTUAR] me pasoja (dëmi biologjik) në shëndetin e të miturit përsa i takon aftësisë për të dëgjuar por edhe zhvillimit personal njësoj si femijët e tjerë të moshës së tij ka ardhur si rezultat i mosveprimit të palës së Paditur për të siguruar dhe vendosur pajisjen e implantit koklear jo vetëm tek I mituri por tek të gjithë pacientët që ndodhen në të njëjtat kushte shëndetësore.

Gjykata vlerëson se për shkak se pala e paditur Ministria e Shëndetësisë nuk ka marrë asnjë masë sipas detyrimeve që burojnë nga VKM-ja në fjalë, për evidentimin, regjistrimin dhe realizimin e ndërhyrjes kirurgjikale për vendosjen e implantit koklear tek i mituri, pasoja ka ardhur dhe është rënduar për shkak të kalimit të kohës duke vështirësuar edhe më tepër rritjen e aftësisë për të dëgjuar dhe rikuperimin e dëgjimit.

Referuar VKM nr. 308, dt.21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, rezulton se (citojmë): Pika 1. Paketa e shërbimit të implantit koklear, sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij vendimi financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Pika 2. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor financon paketat e mësipërme (edhe të implantit koklear) në institucione shëndetësore publike. Pika 6. Fondi administron Regjistrin Kombëtar të Paketave të shërbimeve sipas shtojcave bashkëlidhur. Rregullat, kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrin Kombëtar të Paketave të financuara nga Fondi hartohen nga ky i fundit në bashkëpunim me shefat e shërbimeve përkatëse universitare dhe miratohen nga këshilli administrativ i Fondit brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi. 7. Fondi ngre strukturat për auditimin dhe monitorimin e ofrimit të paketave të shërbimeve nga institucionet shëndetësore publike dhe private të kontraktuara. 10. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar i Fondit

të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për programin e financimit spitalor. 11. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është ngarkuar me ligj për: financimin e paketës së shërbimit të implantit koklear në institucion shëndetësorë publike, ku është ekzaminuar dhe konstatuar aftësia e kufizuar e të miturit [REDAKTUAR] si dhe është rekomanduar Implanti Koklear (kockor); administrimin e Regjistrit Kombëtar të Paketave të shërbimeve përfshirë paketën e shërbimit të implantit koklear; për ngritjen e strukturave për auditimin dhe monitorimin e ofrimit të paketës së këtij shërbimi; për përballimin e efekteve financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi nga buxheti i tij si dhe për zbatimin në tërësi të VKM-së në fjalë. Sa më sipër tregon përgjegjësitë ligjore që ka Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor si palë e paditur dhe që përbën objektin e kërkesë padisë, së bashku me institucionet e tjera sipas përgjegjësisë respektive ligjore. Për rrjedhojë, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është përgjegjës për mospërbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore përsa i takon financimit, administrimit dhe monitorimit të ofrimit të shërbimit të paketës së shërbimit të implantit koklear.

Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se dokumentet e nevojshme mjekësore si, vendimi i konsultës së shërbimit përkatës, formulari i prioritetit të trajtimi apo vendimi i konsultës së shërbimit të urgjencës nëse rasti adresohet nga urgjenca, duhet që të dërgoheshin në formën e duhur ligjore, të firmosura dhe vulosura, nga shërbimi i O.R.L i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, pranë Zyrës së Sektorit të Regjistrit Kombëtar të Paketave me qëllim regjistrimin e pacientit [REDAKTUAR] tek ky regjistër.

Gjykata çmon se, palët e paditura edhe pasi janë vënë në dijeni zyrtarisht përmes ankimit të mësipërm, dhe më pas paraqitjes së kërkesë padisë përpara kësaj gjykate, megjithëse kishin mundësinë për të vepruar administrativisht duke u përcjellë edhe gjithë dokumentacionin provues organeve kompetente, ato nuk kanë reaguar apo njoftuar respektivisht njëra-tjetrën për trajtimin dhe ndjekjen e rastit konkret të paraqitur para tyre, në zbatim të kuadrit ligjor dhe protokolleve përkatëse mjekësore. Rezulton e provuar se asnjë prej këtyre 3 institucioneve të kujdesit shëndetësor publik nuk ka patur reagim, veprim administrativ apo përgjigje, dhe ky mosveprim administrativ i ngarkon këto institucione me përgjegjësi ligjore për pasojën e ardhur në shëndetin e të miturit [REDAKTUAR].

Gjykata gjen të pabazuar dhe prapësimin e përsëritur të Fondit se, qëndrimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi sipas shkresës nr. 133/1 prot, datë 16.02.2017 është i njëanshëm dhe ka marrë të mirëqenë pretendimet e paditësit. Gjykata vlerëson se në qëndrimin e tij zyrtar si një institucion i pavarur dhe i specializuar për ndalimin e diskriminimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bazuar jo në pretendimet, por në provat e paraqitura nga paditësi ku bën pjesë edhe shkresa nr. 1329/1 prot, datë 23.03.2016 e Fondit, me të cilën pohohet se Fondi financon procedurën kirurgjikale të vendosjes së implantit koklear, ndërsa aparatura e implantit koklear sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë. Lista e përfituesve administrohet nga shërbimi përkatës në QSUT, i cili përcakton kriteret mjekësore për përfitimin e kësaj pakete shëndetësore, si dhe në provat e tjera të lëshuara nga palët e paditura të cituara më sipër.

Gjatë gjykimit, eksperti i licensuar i kërkuar nga palët paditëse dhe i caktuar nga gjykata ka bërë llogaritjen e dëmit të shkaktuar të miturit [REDAKTUAR] bazuar në detyrat e lëna po nga gjykata, në provat e paraqitura në dosje si dhe në vendimin unifikues nr. 12, dt.14.09.2007, ëe Gjykatës së Lartë.

Gjykata vlerëson se pacientët sikurse është i mituri [REDAKTUAR] i cilësuar si kandidat për implantin koklear nga Shërbimi i O.R.L.-së, nuk mund të regjistrohet për ndërhyrje

kirurgjikale pranë spitalit pa patur edhe dokumentin autorizues për kryerjen e shërbimit, që lëshohet nga zyra e autorizuar e Fondit, vendimi i konsultës së shërbimit të QSUT, etj. Por, këto dokumente mjekësore dhe administrative lëshohen nga shërbimet dhe zyrat përgjegjëse që ndodhen pranë palëve të paditura, përkatësisht pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Për rrjedhojë, nuk është përgjegjësi e miturit (apo kujdestarëve ligjorë), nëse i mituri nuk i është nënshtruar procedurave përkatëse për t’u trajtuar sipas ligjit me shërbimin e duhur mjekësor.

Gjykata vlerëson se nga këto akte nënligjore rezulton se, përgjegjësia e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë është jo vetëm në kryerjen e ndërhyrjes kirurgjikale në fund të procedurës administrative, por edhe në fillim të kësaj procedure, pasi ajo merr vendim konsulte nga komisioni me mjekë specialistë, si dhe kryen veprimet e tjera formale-administrative për një pacient që vetë e ka cilësuar si kandidat për implant koklear. Për rrjedhojë dhe prapësimi se mungon lidhja shkak-pasojë mes veprimeve apo mosveprimeve administrative të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë dhe dëmit të shkaktuar të miturit është i pabazuar, pasi ky institucion nuk provohet të ketë realizuar përgjegjësitë e caktuara për zbatimin e paketës së implantit koklear për pacientin [REDACTED].

Në përfundim të gjykimit të çështjes, gjykata vlerëson se gjatë hetimit gjyqësor rezultoi se palët e paditura nuk arritën të provojnë në gjykim se prej tyre janë ndërmarrë veprime konkrete për të mundësuar vendosjen e implantit koklear të të miturit [REDACTED], i cili nuk rezulton të ketë përfitur shërbim mjekësor sipas VKM nr. 308, dt.21.05.2014. Përgjegjësia e këtyre organeve është solidare dhe e ndërlidhur, pasi edhe përgjegjësia për vendosjen e implantit koklear (mosveprimet e paligjshme) sipas ligjit përmban detyrime për secilën prej tyre dhe të lidhura me njëra-tjetrën.

Gjykata vlerëson se "Mosveprimi administrativ" nga palët e paditura Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është shkak i drejtpërdrejtë i cili ka shkaktuar diskriminim për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar të të miturit [REDACTED] si dhe njëkohësisht demtimin e shëndetit të tij. Dëmi është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe me faj, si rezultat i mosveprimit për sigurimin dhe vendosjen e aparaturës së implantit koklear.

Në aktin e ekspertimit nga eksperti vlerësues i dëmit shëndetësor është arritur në konkluzionin se, të miturit [REDACTED] i është shkaktuar paaftësi e pjeshme, e përhershme (pra, për gjithë jetën) për punë në masën 35%, dëm i cili i është shkaktuar për shkak të mosvendosjes së implantit koklear nga palët e paditura, duke i shkaktuar dëm të përhershëm. Me avancimin e moshës, shanset e përfitimit të dëgjimit dhe të folurit janë pa rezultat. Ndërsa, në aktin shtesë të ekspertimit, kur flitet për humbjen e aftësisë tek i mituri [REDACTED] në masën mbi 67%, duke përfitur grupin e II të invaliditetit, bëhet fjalë për humbjen e aftësisë në moshën aktuale që është i mituri. Referuar kriterëve objektive për llogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror (si dëm biologjik, dëm moral dhe dëm ekzistencial) si dhe vendimit unifikues nr. 12, dt.14.09.2007, të Gjykatës së Lartë, eksperti i dëmit shëndetësor ka bërë vlerësimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, dhe ka arritur në përfundimin se vlera maksimale e dëmit pasuror dhe jopasuror shkaktuar të miturit [REDACTED] është në vlerën 6.838.590 lekë.

Në shpjegimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi thirrur në gjykim në cilësinë e personit të tretë, është arritur në konkluzionin se, sipas ligjit nr. 10 221, dt.04.02.2019 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, aftësia e kufizuar e të miturit [REDACTED] përbën shkak të ndaluar diskriminimi. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se, ka baza për prezumimin e diskriminimit të të miturit [REDACTED] për shkak të aftësisë së kufizuar, në formën e “Mohimit të përshtatjes së arsyeshme” në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve si pasojë e mosveprimit të autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e pajisjes dhe vendosjen, nëpërmjet ndërhyrjes kirurgjikale, të implantit koklear (CI).

Në këto kushte, mbi bazën e analizës ligjore të sipercituar, gjykata vlerëson në përfundim të gjykimit se duhet të procedojë me pranimin e padisë së paditësit [REDAKTUAR] duke konstatuar diskriminimin në formën e “Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme” ndaj fëmijës së mitur [REDAKTUAR].

Gjykata vlerëson se po kështu duhet të rregullojë dhe pasojat e riparojë dëmin e ardhur për interesat e të miturit, duke proceduar me detyrimin e palëve të paditura që solidarisht ë marrin masat për shpërbllimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuuese përmes riparimit të shkeljeve ligjore dhe pasojave të ardhura: a) kryerjes së veprimeve administrative për sigurimin dhe vendosjen e implantit koklear për fëmijën e mitur me probleme të dëgjimit [REDAKTUAR] b) kompensimin e dëmit në formën e dëmtimit të shëndetit në masën 6.838.590 lekë.

Pra, gjykata vlerëson se duhet të procedojë me pranimin e padisë së paditësit [REDAKTUAR] si përfaqësues ligjor i fëmijës së mitur [REDAKTUAR], ndërkohë që në lidhje me legjitimitetin e palës paditëse Komiteti Shqiptar i Helsinkit, gjykata çmon se ligji i posaçëm, ligji nr. 10 221, dt.04.02.2019 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenet 34 e vijues nuk parashikon ushtrimin e padisë në emër të organizatës, sikurse ka vepruar pala paditëse në këtë gjykim, por në emër të subjektit për të cilin kjo organizatë po vepron, e për rrjedhojë padia duhet të ishte ushtruar në emër të të miturit [REDAKTUAR] dhe jo në emër të organizatës, ndaj padia gjendet e pabazuar për sa i përket palës paditëse Komiteti Shqiptar i Helsinkit.

Në nenin 34, pikat 1, 2 dhe 3, të këtij ligji thuhet se: “Subjektet që kanë të drejtë të paraqesin padi për diskriminim; 1. Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesë padi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërbllim sipas ligjit, ose sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale; 2. Paraqitja e ankimit përpara komisionarit nuk është kusht për të paraqitur një kërkesë padi dhe nuk përbën pengesë për personin e dëmtuar t'i drejtohet gjykatës ose organeve të ndjekjes penale; 3. Një organizatë me interes të ligjshëm ose komisionari mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që komisionari ose organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi”.

Në përfundim të gjykimit të çështjes, gjykata vlerëson se duhet të procedojë me pranimin e pjeshëm të padisë për sa i përket paditësit [REDAKTUAR] ndërkohë që duhet të procedojë me rrezimin e pjesës tjetër të padisë për sa i përket paditësit Komiteti Shqiptar i Helsinkit, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv, i cili këtë padi mund ta ushtronte vetëm duke cilësuar si paditës të miturin [REDAKTUAR] dhe të përfaqësonte si përfaqësues i legjitimuar interesat e këtij të mituri.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Në analizë të ankimeve dhe shkaqeve të ngritura nëpërmjet tyre, të vendimit objekt ankimi, të akteve të dosjes si dhe në referim të përcaktimeve të ligjit të posaçëm dhe atij procedural që gjejnë zbatim në rastin konkret, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, vendimi nr.1250, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material e si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Për sa i përket pretendimeve të të paditurve/ankues dhe Avokaturës së Shtetit, ky Kolegj vlerëson të jenë të pabazuara në ligj.

Nga aktet shkresore provë në dosjen gjyqësore rezulton se, paditësi shtetasi [REDAKTUAR] është babai i fëmijës së mitur, të sëmurë [REDAKTUAR] i datëlindjes 04.02.2013, i cili është diagnostikuar si problem i lindur me “Hypoacusia billateralis profunda surdomutisim”, ose shurdhësi e rëndë në të dy veshët.

Në referim të dokumentit “Përmbledhje e daljes”, datë 27.10.2015, të lëshuar nga Shërbimi i O.R.L i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, për shkak të invaliditetit dhe paaftësisë rezulton të jetë rekomanduar që i mituri [REDAKTUAR] të trajtohet me KEMP si dhe është cilësuar kandidat për CI ose për implant koklear.

Sipas “Fletë drejtimi për KEMP”, datë 29.10.2015, të Komisionit Mjekësor të Shërbimit O.R.L, të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, rezulton të jetë rekomanduar që për mjekimin e problemit në dëgjim i mituri [REDAKTUAR] t’i nënshtrohet CI (implantit kokcor). Implanti Koklear (CI), e cila është një aparaturë elektronike, që implantohet ose vendoset tek njeriu në mënyrë kirurgjikale dhe që mundëson dëgjimin tek një person i cili është plotësisht i shurdhër ose që ka një humbje të thellë të degjimit. Kjo aparaturë sjell zë apo tingull në veshin e paaftë për të degjuar.

Me vendimin nr. 27925, datë 17.12.2015, Komisioni Mjekësor i caktimit të aftësisë për punë Pogradec ka vendosur që, i mituri Gisel Leka të ketë humbur aftësinë për punë në masën e Gr. 2 (ku klasifikohen shtetasit me humbje të dëgjimit), prej datës 17.12.2015 deri në datë 30.11.2016.

Sipas shkresës nr. 1329/1, datë 23.03.2016 “Përgjigje shkrese” të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor drejtuar shoqatës “Together for Life”, konfirmohet se, Fondi financon procedurën kirurgjikale të vendosjes së implantit koklear, ndërsa aparatura e implantit koklear sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë. Lista e përfituesve administrohet nga shërbimi përkatës në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, i cili përcakton kriteret mjekësore për përfitimin e kësaj pakete shëndetësore.

Sipas shkresës nr. 1513/1, datë 22.04.2016 “Kthim përgjigje”, të Drejtorisë së Administrimit Spitalor në Ministrinë e Shëndetësisë drejtuar Shoqatës “Together for Life” rezulton se, Ministria e Shëndetësisë ka ngritur grup pune, i cili është punon për të bërë studimin përkatës me qëllim përfshirjen e aparateve kokleare në listën e rimbursimit nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, e cila do të jetë dhe mënyra e zgjidhjes përfundimtare të realizimit të implantit koklear.

Sipas dokumenteve, Raportit Mjekësor datë 31.10.2016, të Shërbimit të Kirurgjisë Infantile O.R.L pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, dhe Raportit Mjekësor datë 24.10.2016, të Departamentit të Otorinolaringologjisë në Spitalin [REDAKTUAR] Tiranë, Implantimi Koklear (CI) është e vetmja zgjidhje për korigjimin e problemit në dëgjim. Duke patur parasysh moshën aktuale të të miturit [REDAKTUAR] është sugjeruar që ndërhyrja kirurgjikale të kryhet sa më shpejt të jetë e mundur.

Në bazë VKM nr. 308, datë 21.05.2014, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, VKM e cila ka hyrë në fuqi në 04.06.2014, paketa e shërbimit të implantit koklear (si një nga paketat falas për pacientët) financohet plotësisht si shërbim i rimbursueshëm nga ky Fond. Ndërsa, aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE- së, sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë.

Në kushtet kur rezultojn të jetë rekomanduar nga mjekët dhe për shkak të mungesës së veprimt të palës së paditur, paditësit [REDAKTUAR] dhe KSHH, përmes shkresës nr. 542-542/2, datë 16.11.2016 "Ankim ndaj mosveprimit administrativ për vendosjen e implantit koklear (CI) për pacientin e mitur me probleme të dëgjimit [REDAKTUAR]" të KSHH, i janë drejtuar me ankim administrativ palës së paditur Ministria e Shëndetësisë, e cila nuk rezultojn që të ketë kthyer përgjigje në lidhje me ankimin e paraqitur nga pala paditëse.

Për sa më sipër, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, me kërkesë padi, duke pretenduar sipas objektit dhe bazës ligjore si më lart cituar.

Këtij Kolegji i rezultojn e provuar se, aftësia e kufizuar e të miturit Gisel Leka të ketë konstatuar nga Komisioni Mjekësor të Shërbimit ORL, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë, të cilët kanë përcaktuar edhe domosdoshmërinë për vendosjen e implantit koklear. Në këtë kuadër vlerësohet se, është përgjegjësi ligjore e shtetit të sigurojë kushtet dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e nevojave për shërbime dhe përkujdesje me qëllim minimizimin apo heqjen e pengesave për përfshirje si dhe për rritjen në maksimum të autonomisë dhe jetesës së pavarur të personave me aftësi të kufizuara.

Ky Kolegj konstaton se, pavarësisht garancive kushtetuese dhe ligjore të cituara më sipër, për mbrojtjen shëndetit dhe kurimin e sëmundjes së të miturit [REDAKTUAR], i cili përfaqëson një komunitet të konsiderueshëm të të miturve me probleme të dëgjimit, nga palët e paditura është shkelur legjislacioni në fuqi, me pasoja të rënda për shëndetin e tij pasi ai rrezikon të mbetet i shurdhër sepse nuk i sigurohet mjekimi i përshtatshëm.

Sipas dokumentit "Përmbledhje e daljes" datë 28.10.2015, pas shtrimit të pacientit [REDAKTUAR] për ekzaminim mjekësor pranë shërbimit O.R.L, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë ai është cilësuar si kandidat për CI ose për implant koklear.

Me vendimin nr. 27925, datë 17.12.2015, Komisioni Mjekësor i caktimit të aftësisë për punë Pogradec ka vendosur se i mituri [REDAKTUAR] e ka humbur aftësinë për punë në masën e Gr. 2 (ku klasifikohen shtetasit me humbje të dëgjimit), prej datës 17.12.2015 deri në datë 30.11.2016. Për periudhën 2016-2017 dhe në vazhdim, i mituri është ekzaminuar nga KMCAP Pogradec dhe rezultojn se, trajtohet sërish me KEMP.

Në vazhdim ai është protezuar me aparate dëgjimi konvencionale, si dhe i është nënshtruar terapi së logopedike intensive dhe në mungesë të efektivitetit të këtij mjekimi, ky shërbim i ka rekomanduar pacientit të mitur [REDAKTUAR], Implantimin Koklear (CI) si e vetmja zgjidhje për korigjimin e problemit në dëgjim.

Ky Kolegj mban në konsideratë sa përcaktuar në ligjin nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara" ligj, i cili si qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes si dhe përcakton përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qëndrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri (neni 2, germat "a" dhe "b", i ligjit).

Vlerësohet se, në kuptim të këtij ligji “Mohim i përshtatjes së arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur mohohet ose kundërshtohet kryerja e rregullimeve ose ndryshimeve të domosdoshme dhe të përshtatshme që janë të nevojshme në një rast të veçantë, pa vendosur një barrë të tepruar, me qëllim garantimin që personat me aftësi të kufizuara të mund të gëzojnë dhe të ushtrojnë, në kushte të barabarta me të tjerët, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 3, pika 6, e ligjit).

Referuar pikës 1, germa “d”, si dhe shtojcës 5, të VKM nr. 308, dt.21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor”, VKM e cila ka hyrë në fuqi në dt. 4 qershor 2014, paketa e shërbimit të implantit koklear (si një nga paketat falas për pacientët) financohet plotësisht si shërbim i rimbursueshëm nga ky Fond dhe përfshin sigurimin e pajisjes së implantit koklear, si dhe procedurën kirurgjikale për vendosjen e tij në veshin e fëmijëve, siç është i mituri Gisel Leka. Nga pikëpamja teknike, kjo VKM përcakton se, aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BF-së, sigurohet në çdo rast nga Ministria e Shëndetësisë.

Në vlerësim të fakteve të lartëcituara si dhe parashikimeve dhe garancive kushtetuese si dhe parashikimeve që bën ligji specifik për diskriminimin vlerësohet se, pretendimet e palës paditëse [REDAKTUAR], përfaqësues ligjor i fëmijës së mitur, se në rastin objekt gjykimi, kemi të bëjmë me “Mohim të një përshtatje të arsyeshme” ndaj të miturit [REDAKTUAR], mohim i cili është shfaqur në mosveprimet e palës së paditur, për të siguruar dhe vendosur aparaturën e implantit koklear tek i mituri, vlerësohen të bazuara në ligj e prova, kjo pasi provohet se:

-Shërbimi i ORL-së së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, si dhe specialistët e fushës së shëndetësisë kishin rekomanduar që prej datës 31.10.2016, që i mituri Gisel Leka si të vetmen zgjidhje për korigjimin e problemit në dëgjim t’i nënshtrohej ndërhyrjes kirurgjikale për vendosjen e CI (implantit koklear).

-Gjithashtu sipas vlerësimit të tyre, me kalimin e kohës vendosja e implantit është e paefektshme duke sjellë si pasojë invaliditetin e përhershëm.

-Në respektim të detyrimeve që burojnë nga ligji (VKM nr. 308, datë 21.05.2014), për mjekimin e të miturit [REDAKTUAR] nga të paditurit Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk është bërë asnjë veprim për sigurimin e implantit koklear dhe kryerjen e ndërhyrjes së specializuar kirurgjikale tek i mituri.

Gjykatës i rezulton e provuar se, i mituri është në gjëndje shëndetësore të tillë që duhet t’i sigurohet “përshtatja e arsyeshme” përmes vendosjes së implantit koklear, trajtimi i tij i diferencuar është i justifikuar madje i detyruar me ligj (VKM përkatëse). Garantimi falas i paketës së shërbimit të implantit koklear, të miratuar me VKM nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në shërbimin spitalor” për të miturit me probleme të rënda të dëgjimit sikurse i mituri [REDAKTUAR] nuk përbën barrë të tepruar apo disproporcionale përderisa vetë shteti Shqiptar ka marrë përsipër mbulimin falas të këtij shërbimi.

Ky Kolegj vlerëson të pabazuara në ligj e prova, pretendimet e të paditurve/ankues dhe Avokaturës së Shtetit se, mungon lidhja shkakësore për ardhjen e dëmit nuk është i bazuar. Diskriminimi i të miturit [REDAKTUAR] me pasoja (dëmi biologjik) në shëndetin e të miturit përsa i takon aftësisë për të dëgjuar.

Ky Kolegj vlerëson se, për shkak se pala e paditur, Ministria e Shëndetësisë nuk ka marrë asnjë masë sipas detyrimeve që buron nga VKM-ja në fjalë, për evidentimin, regjistrimin dhe realizimin e ndërhyrjes kirurgjikale për vendosjen e implantit koklear tek i mituri, pasoja ka ardhur dhe është rënduar për shkak të kalimit të kohës duke vështirësuar edhe më tepër rritjen e aftësisë për të dëgjuar dhe rikuperimin e dëgjimit.

Ky Kolegj vlerëson se, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është ngarkuar me ligj për: financimin e paketës së shërbimit të implantit koklear në institucion shëndetësor publik, ku është ekzaminuar dhe konstatuar aftësia e kufizuar e të miturit Gisel Leka si dhe është rekomanduar Implanti Koklear (kockor); administrimin e Regjistrimit Kombëtar të Paketave të shërbimeve përfshirë paketën e shërbimit të implantit koklear; për ngritjen e strukturave për auditimin dhe monitorimin e ofrimit të paketës së këtij shërbimi; për përballimin e efekteve financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi nga buxheti i tij si dhe për zbatimin në tërësi të VKM-së në fjalë.

Vlerësohet se, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor është përgjegjës për mospërbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore përsa i takon financimit, administrimit dhe monitorimit të ofrimit të shërbimit të paketës së shërbimit të implantit koklear.

Ky Kolegj vlerëson se, në qëndrimin e tij zyrtar si një institucion i pavarur dhe i specializuar për ndalimin e diskriminimit në fusha të ndryshme të jetës shoqërore, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bazuar jo në pretendimet, por në provat e paraqitura nga paditësi ku bën pjesë edhe shkresa nr. 1329/1 prot, datë 23.03.2016 e Fondit, me të cilën pohohet se Fondi financon procedurën kirurgjikale të vendosjes së implantit koklear, ndërsa aparatura e implantit koklear sigurohet nga Ministria e Shëndetësisë. Lista e përfituesve administrohet nga shërbimi përkatës në QSUT, i cili përcakton kriteret mjekësore për përfitimin e kësaj pakete shëndetësore, si dhe në provat e tjera të lëshuara nga palët e paditura të cituara më sipër.

Sikurse rezulton e provuar eksperti i licensuar i kërkuar nga palët paditëse dhe i caktuar nga gjykata e shkallës së parë ka bërë llogaritjen e dëmit të shkaktuar të miturit [redacted] bazuar në detyrat e lëna nga gjykata dhe në provat e paraqitura në dosje si dhe në vendimin unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 të Gjykatës së Lartë.

Ky Kolegj vlerëson se, pacientët sikurse është i mituri [redacted], i cilësuar si kandidat për implantin koklear nga Shërbimi i O.R.L.-së, nuk mund të regjistrohet për ndërhyrje kirurgjikale pranë spitalit pa patur edhe dokumentin autorizues për kryerjen e shërbimit, që lëshohet nga zyra e autorizuar e Fondit, vendimi i konsultës së shërbimit të QSUT, etj. Por, këto dokumente mjekësore dhe administrative lëshohen nga shërbimet dhe zyrat përgjegjëse që ndodhen pranë palëve të paditura, përkatësisht pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ky Kolegj vlerëson se, "Mosveprimi administrativ" i të paditurve është shkaku i drejtpërdrejtë i cili ka shkaktuar diskriminim për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar të të miturit [redacted], si dhe njëkohësisht demtimin e shëndetit të tij. Dëmi është shkaktuar në mënyrë të paligjshme dhe me faj, si rezultat i mosveprimit për sigurimin dhe vendosjen e aparaturës së implantit koklear.

Në aktin e ekspertimit të administruar në dosjen gjyqësore, të kryer nga eksperti vlerësues i dëmit shëndetësor, i caktuar nga gjykata është arritur në konkluzionin se, të miturit Gisel Leka i është shkaktuar paafësi e pjesshme, e përhershme (pra, për gjithë jetën) për punë në masën 35%, dëm i cili i është shkaktuar për shkak të mosvendosjes së implantit koklear nga palët e paditura, duke i shkaktuar dëm të përhershëm. Ndërsa, në aktin shtesë të ekspertimit, kur flitet për humbjen e aftësisë tek i mituri [REDAKTUAR] në masën mbi 67%, duke përfitur grupin e II të invaliditetit, bëhet fjalë për humbjen e aftësisë në moshën aktuale që është i mituri. Referuar kritereve objektive për llogaritjen e dëmit pasuror dhe jopasuror (si dëm biologjik, dëm moral dhe dëm ekzistencial) si dhe vendimit unifikues nr. 12, datë.14.09.2007, të Gjykatës së Lartë, eksperti i ka bërë vlerësimin e dëmit pasuror dhe jopasuror, dhe ka arritur në përfundimin se vlera maksimale e dëmit pasuror dhe jopasuror shkaktuar të miturit Gisel Leka është në vlerën 6.838.590 lekë.

Ky Kolegj ashtu sikurse gjykata e shkallës së parë mban në konsideratë, shpjegimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi thirrur në gjykim në cilësinë e personit të tretë, i cili ka arritur në konkluzionin se, sipas ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2019 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, aftësia e kufizuar e të miturit Gisel Leka përbën shkak të ndaluar diskriminimi, vlerësohet se ka baza për prezumimin e diskriminimit të të miturit [REDAKTUAR] për shkak të aftësisë së kufizuar, në formën e “Mohimit të përshtatjes së arsyeshme” në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve si pasojë e mosveprimit të autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e pajisjes dhe vendosjen, nëpërmjet ndërhyrjes kirurgjikale, të implantit koklear (CI).

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson të drejtë e të bazuar në ligj përfundimin e arritur nga gjykata e shkallës së parë, e cila ka konkluduar në pranimin e pjesshëm të padisë, konstatimin e diskriminimit në formën e ‘Mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme’ ndaj fëmijës së mitur [REDAKTUAR] dhe detyrimin e të palëve të paditura, që solidarisht të marrin masa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sjellja diskriminuese nëpërmjet kryerjes së veprimeve administrative për sigurimin dhe vendosjen e implantit koklear për të miturin [REDAKTUAR] dhe kompensimin e dëmit në formën e dëmtimit të shëndetit në masën 6.838.590 lekë.

Gjithashtu nga ky Kolegj gjendet i bazuar në ligj përfundimi i arritur nga gjykata e shkallës së parë në lidhje me rrëzimin e padisë, përse i përket paditësit Komiteti Shqiptar i Helsinkit për mungesë të legjitimitetit aktiv për sa kërkohet të realizohet nëpërmjet padisë, objekt shqyrtimi përpara gjykatës.

Sa më sipër, pretendimet e parashtruara nga palët e paditura dhe Avokatura e Shtetit në ankimet e tyre përpara Gjykatës Administrative të Apelit për kundërshtimin e vendimit nr.1250, datë 10.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, janë të pabazuara në ligj dhe në prova dhe si të tilla të papranueshme.

Në rrethanat e përshkruara sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 gërma “b” të ligjit Nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, vlerëson se vendimi nr.1250, datë 10.04.2018 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të neneve 50 gërma "b" të ligjit Nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr.1250, datë 10.04.2018 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve afat që fillon nga e nesërmyja e komunikimit të këtij vendimi të arsyetuar.

-U shpall sot në Tiranë, më datë 19.06.2019

GJYQTARE
Bernina KONDI
d.v

GJYQTARE
Enkelejda METALIAJ (Softa)
d.v
Vërtetohet njësisë me origjinalin

GJYQTAR
Kastriot SELITA
d.v

KANCELAR ⁽LEONARD STRATAJ



